



CPT/Inf (2009) 4

Përgjigje e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në Raportin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimit Jorhuman apo Degradues (KOMITETI) mbi vizitën e tij në Kosovë prej 21 deri më 29 mars 2007

Përmbajtja

Hyrja	-2-
Institucionet nën autorizimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme	-3-
A. Ndalimi në polici	-3-
Keqtrajtimi	-3-
Mbrojtja	-9-
Kushtet e paraburgimit	-13-
Çështje të tjera	-14-
Institucionet nën autorizimin e Ministrisë së Drejtësisë	-15-
B. Institucionet ndëshkimore	-15-
Keqtrajtimi	-15-
Kushtet materiale për paraburgim.....	-18-
Regjimi	-21-
Kujdesi shëndetësor	-26-
Çështje të tjera	-30-
Institucionet nën autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale	-31-
C. Institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale	-31-
Vërejtjet preliminare	-31-
Keqtrajtimi.....	-31-
Kushtet e jetesës së pacientëve/banorëve	-33-
Stafi.....	-34-
Trajtimi	-35-
Përmbajtja nga pacientët/banorët e shqetësuar dhe/ose të dhunshëm	-35-
Mbrojtja.....	-36-

Hyrje

Administrata e Përkohshme e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka kënaqësinë që Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Johuman dhe Degradues (Komiteti) t'i paraqesë këtë përgjigje për Raportin e Komitetit.

Komiteti e ka vizituar Kosovën prej 21 deri më 29 mars 2007. Kjo vizitë ishte e bazuar në marrëveshjen e 23 gushtit 2004 në mes të UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës mbi marrëveshjet teknike lidhur me Konventën Evropiane mbi Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Johuman dhe Degradues.

UNMIK-u dëshiron të falënderoj Komitetin për vizitën dhe raportin rezultues. UNMIK-u sikurse edhe ministritë e Kosovës të gjeturat e Komitetit i kanë marrë me seriozitet të madh dhe janë mirënjohës për rekomandimet e bëra për përmirësim.

Përgjigjja në Raportin e Komitetit është përgatitur me kontribute të rëndësishme nga ministritë lokale ajo e Drejtësisë, e Punëve të Brendshme dhe e Shëndetësisë.

Përgjigjja i përmbahet strukturës së Shtojcës I të Raportit. Rekomandimet e Komitetit, komentet dhe kërkesat për informacione janë paraqitur me shkronja të zeza (bold).

Institucionet nën autorizimin e Ministrisë vendore të Punëve të Brendshme

A. Ndalimi në polici

Keqtrajtimi

Paragrafi 13

Komiteti rekomandon që të gjithë zyrtarëve të SHPK-së t’iu dorëzohet një deklaratë formale e lëshuar nga autoriteti më i lartë politik kompetent (duke përfshirë edhe policinë kriminale), duke i përkujtuar ata se duhet t’i respektojnë të drejtat e personave të arrestuar dhe se keqtrajtimi i personave të tillë do t’i nënshtrohet sanksioneve të ashpra. Ata gjithashtu duhet të përkujtohen se nuk lejohen të përdorin forcë më tepër se sa saktësisht është e nevojshme gjatë kapjes së personit;

Ministria vendore e Punëve të Brendshme, e cila është në dijeni për rekomandimet e Komitetit, pajtohet që të drejtat e personave të arrestuar dhe të paraburgosur të respektohen në mënyrë strikte. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë hapa për të siguruar që Policia e Kosovës vepron në përputhje me standardet e aplikueshme mbi të drejtat e njeriut.

Në korrik të vitit 2007, u mblodh një ekip i zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të cilët punonin nën departamentin operacional të Policisë së Kosovës, për identifikimin e problemeve dhe të metave në stacionet e policisë duke mbajtur qendra në të gjitha regionet e Kosovës dhe duke i vënë nën përkujdesjen e menaxhmentit të Policisë së Kosovës.

Më tutje, në harmoni me raportin e Komitetit, në tetor të vitit 2007 të gjithë komandantët regjional të Policisë së Kosovës morën një urdhëresë duke i informuar ata për rekomandimet e Komitetit dhe për veprimet që duhet të ndërmerren për të trajtuar problemet e identifikuara.

Lidhur me personin e paraburgosur i cili e kishte informuar Komitetin se ishte keqtrajtuar nga një polic në stacionin policor të Deçanit (paragrafi 11), departamenti operacional i Policisë së Kosovës me kujdes i ka shqyrtuar këto pohime.

Të gjeturat e deritanishme tregojnë se incidenti specifik i paraqitur në raportin e Komitetit për keqtrajtim në stacionin policor në Deçan nuk mund të verifikohet pa të dhëna shtesë. Sipas Policisë së Kosovës, nuk ka shënime për ndonjë deklaratë nga ndonjë person i paraburgosur, i cili është ankuar për keqtrajtimin e përshkruar. Janë marrë në pyetje 60 polic të Policisë së Kosovës dhe asnjëri nga policët e intervistuar nuk i kujtohej ndonjë incident i tillë. Nuk ka pasur deklaratë të dorëzuar nga zyrtarët e policisë ndërkombëtare të cilët gjoja se kanë intervenuar për të mundësuar trajtimin mjekësor dhe nuk është regjistruar asnjë intervenim mjekësor. Përfundimisht, nuk mund të gjendeshin të dhëna shtesë për të provuar këto pohime.

Duke pasur parasysh mungesën e provave, si dhe mosnjohuritë për kohën kur ky incident i pohuar ka ndodhur si dhe emrin e personit të paraburgosur, nuk është e mundshme që këtij rasti t'i qasemi në mënyrë bindëse. Nëse Komiteti ka informacione shtesë për këtë rast, Policia e Kosovës dëshiron t'i merr ato të dhëna për të hetuar më tutje këto pohime.

Lidhur me përdorimin e forcës nga policët e Policisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme është shumë e vetëdijshme për rëndësinë e respektimit të parimit të proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë – njëra prej arsyeve pse i kushtohet rëndësi e madhe në raportin e Komitetit.

Si rregull, zyrtarët e Policisë së Kosovës mund të përdorin forcë të domosdoshme dhe proporcionale vetëm gjatë arrestimeve dhe procedurave të paraburgimit, në pajtim me ligjin në fuqi.¹ Në këtë aspekt, menaxhmenti i Policisë së Kosovës i kushton rëndësi të madhe parandalimit të sjelljes joprofesionale dhe të paligjshme të policëve ndaj personave të paraburgosur dhe personave që u nënshtrohen procedurave policore. Mjetet kundër sjelljes së tillë janë të parapara në kornizën ekzistuese legjislative: ligji në fuqi lidhur me policinë parasheh shqiptimin e sanksioneve të rënda ndaj policëve të cilët nuk i respektojnë të drejtat e personave të ndaluar.²

Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me menaxhmentin e Policisë së Kosovës ndihmojnë në hartimin e legjislacionit sekondar dhe procedurave operative. Në mesin e draftlegjislacionit që aktualisht është duke u finalizuar është Ligji administrative për kundërvajtjet dhe kundërvajtjet serioze. Ky draftlegjislacion synon që të forcojë sanksionet e shqiptuara kundër policëve të Policisë së Kosovës të cilët përdorin forcë pa nevojë dhe/ose në mënyrë joproportionale.³ Veprimet e tilla në të ardhmen do të bëhen kundërvajtje serioz, dhe me këtë legjislacion do t'i mundësohet Prokurorisë që të paraqesë kallëzime penale ndaj policëve të Kosovës.

Përdorimi adekuat i forcës dhe mbikëqyrja e të drejtave njerëzore fundamentale gjatë procedurave policore janë pjesë esenciale e trajnimit gjithëpërfshirës që u është ofruar policëve të Policisë së Kosovës. Trajnimet themelore institucionale përfshijnë orë mbi të drejtat e njeriut dhe nga pjesëtarët e rinj në stafin e Policisë së Kosovës kërkohet që ata të kalojnë një test mbi të drejtat e njeriut para se ata të marrin përsipër detyrat e tyre. Orë mbi të drejtat e njeriut gjithashtu sigurohen edhe për policët e Kosovës në të gjitha trajnimet institucionale që janë në vazhdim e sipër.

Në shtator të vitit 2008, u mbajt një projekt “Trajnimi i trajnerëve” në Qendrën kosovare për edukimin dhe zhvillimin e sigurisë publike. Qëllimi ishte që të trajnohen instruktorët profesionalë mbi të drejtat e njeriut, kodin policor mbi etikën dhe

¹Neni 12 dhe 25 i Ligjit mbi policinë, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008. Vini re se përdorimi i forcës gjatë arrestit dhe paraburgimit gjithashtu është e rregulluar me Doracakun mbi procedurat dhe politikat e Shërbimit Policor të Kosovës të vitit 2007. Numri i rregullës 4-14 (akoma në fuqi).

² . Nenet 46,47,48 dhe 49 të Ligjit mbi policinë.

³ Neni 164 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, 6 korrik 2003, trajton keqtrajtimet gjatë ushtrimit të detyrave.

përdorimin e forcës, të cilët më pastaj do të ofronin trajnime për policët e Policisë së Kosovës në të gjashtë regjionet e Kosovës deri në fund të vitit 2008.⁴

Përveç kësaj, në kuadër të kornizës për edukim të vazhdueshëm, menaxhmenti i Policisë së Kosovës gjithashtu pranon oferta nga institucione dhe organizata të tjera për të mbajtur kurse mbi të drejtat e njeriut për policët e Policisë së Kosovës, me kusht të temat të mos jenë të mbuluara në trajnimet e brendshme dhe janë në kuadër të punës së Policisë së Kosovës.

Vëmendje e posaçme u është dhënë policëve të Policisë së Kosovës të cilët janë në detyrë të përhershme në qendrat e mbajtjes. Pas rekomandimit nga Komiteti i Njesisë së Policisë së UNMIK-ut për parandalimin e torturës,⁵ janë siguruar trajnime të veçanta për policët e Kosovës të cilët shërbejnë vetëm në qendrat e mbajtjes në nëntor të vitit 2007. Këto trajnime, të siguruar nga Departamenti i trajnimeve të Shërbimit Policor të Kosovës, shërbyen për të avancuar njohuritë mbi aspektet e ndryshme të procesit të arrestit dhe paraburgimit dhe për të profesionalizuar qasjen e policëve të Kosovës në procedimin dhe ruajtjen e standardeve ndërkombëtare gjatë procesit të paraburgosjes.

Për ta përmbledhur, kombinimi i kornizës ekzistuese legjislative dhe kurset e vazhdueshme të trajnimit shërbejnë vazhdimisht për të përkujtuar stafin e Policisë së Kosovës mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave të personave të ndaluar.

Ministria e Punëve të Brendshme potencon se organizatave joqeveritare u është dhënë leje, për qëllime të monitorimit, që atyre u mundëson qasje të papenguar në stacione të policisë, duke përfshirë edhe qelitë e mbajtjes. Ky monitorim i pavarur nga shoqëria civile e Kosovës e mbështet edhe më shumë Policinë e Kosovës që veprojnë në përputhje me ligjet në fuqi dhe me standardet mbi të drejtat e njeriut.

Paragrafi 13

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa adekuat për të siguruar që personat të cilët kanë mundur të jenë viktimë të keqtrajtimit nga policët të kenë mundësi që në mënyrë efektive të paraqesin ankesë formale;

Është vendosur sistemi për paraqitjen e ankesave formale dhe ai është funksional. Doracaku mbi politikën dhe procedurat e Shërbimit Policor të Kosovës (Doracaku mbi politikën dhe procedurat) i sqaron detajisht procedurat në dispozicion dhe parasheh hetimin e ankesave të qytetarëve apo personave të arrestuar kundër Policisë së Kosovës, pavarësisht nëse ankesa është pranuar me shkrim apo gojarisht.⁶

Draftlegjislacioni administrativ i sipërpërmendur mbi kundërvajtjet dhe kundërvajtjet serioze gjithashtu parasheh domosdoshmërinë për pranimin e ankesave nga qytetarët.

⁴ Trajnimi është ofruar me sugjerimin e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

⁵ Njësia e Komitetit të Policisë së UNMIK-ut për parandalimin e torturës u themelua në kuadër të Njesisë së inspektimit të Policisë së UNMIK-ut në korrik të vitit 2007 për të inspektuar qelitë e mbajtjes në polici dhe për të dhënë rekomandime mbi përmirësimin e kushteve në ato qeli. Kjo njësi është themeluar aty për aty dhe është shpërndarë pas tre muajsh. Njëra prej rekomandimeve të saja ishte që të ofronte trajnime speciale për policët të cilët shërbenin vetëm në qendrat e mbajtjes.

⁶ 2007 Doracaku mbi politikën dhe procedurat e Shërbimit Policor të K, Numri i rregullës 4-20.

Sipas këtij ligji, prishja apo ndryshimi i ankesës konsiderohet kundërvajtje serioze; të dyja veprat do të sanksionohen në përputhje me rrethanat.

Ligji në fuqi mbi policinë parasheh të drejtën për parashtrimin e ankesës. Ky ligj parasheh që të gjithë qytetarët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesa kundër zyrtarëve të policisë të të gjitha gradave, si dhe kundër shërbyesve civil të cilët punojnë në Policinë e Kosovës.⁷

Që nga vizita e Komitetit, të gjitha stacionet policore janë pajisur me postera ku ilustruhet procesi i paraqitjes së një ankesë formale në të gjitha viset ku ka qasje popullore,

Departamenti i Hetimeve në Inspektoratin e Policisë së Kosovës filloi punën në tetor të vitit 2007. Departamenti i Hetimeve inicion hetime të brendshme kundër stafit të Policisë së Kosovës dhe heton ankesat e qytetarëve mbi shkeljet e rënda disiplinore. Dosjet e rastit të përgatitur nga Departamenti i Hetimeve përfshijnë rekomandimet dhe ato dërgohen për rishqyrtim në Komitetin për Emërime të Larta në Polici dhe për Disiplinë.

Si e tillë, procedura e ankesës siguron që çdo qytetar të paraqesë ankesë kundër Policisë së Kosovës, e cila hetohet plotësisht nga autoritetet relevante.

Paragrafi 14

Komiteti u rekomandon autoriteteve relevante që të sigurojnë se, çdoherë kur një person i kapur i sjell para prokurorit ose gjyqtarit pohon keqtrajtim nga ana e policisë, ato pohime regjistrohen me shkrim, menjëherë urdhërohet një kontrollim i mjekësisë ligjore, dhe ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar hetimin e duhur të pohimeve. Një qasje e tillë duhet të zbatohet pavarësisht nëse personi në fjalë ka apo nuk ka lëndime të dukshme. Për më tepër, edhe në mungesë të një pohimi të shprehur të keqtrajtimit, prokurori apo gjyqtari duhet të kërkojë një kontrollim të mjekësisë ligjore çdoherë kur ka arsye të tjera (p.sh. lëndime të dukshme; pamja e përgjithshme e personit ose mënyra e sjelljes) për të besuar se mund të jetë bërë keqtrajtim;

Më tutje, Komiteti rekomandon ndërmarrjen e hapave adekuate për të siguruar që prokurorët/gjyqtarët t'i zbatojnë procedurat ashtu që personat në fjalë të kenë mundësi të vërtetë të japin deklaratë për mënyrën në të cilën janë trajtuar.

Gjyqtarët dhe prokurorët janë të obliguar të zbatojnë ligjin dhe parimin e kujdesit të duhur gjatë tërë procedurave. Keqtrajtimi përbën vepër penale sipas Kodit të Përkohshëm Penal.⁸

Në këtë aspekt, duhet të iniciohen hetimet nga prokurori.⁹

⁷Neni 10, Ligji mbi Policinë e Kosovës dhe Doracaku procedural, Numri i rregullës 4-20.

⁸Neni 164, Keqtrajtim në ushtrimin e detyrave, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, 6 korrik 2003. Neni 220 paragraf. 1, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Procedurës Civile të Kosovës, 6 korrik 2003.

⁹Neni 220 paragraf. 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, 6 korrik 2003.

Nëse personi vendos që të mos e informojë gjyqtarin apo prokurorin për keqtrajtimi që ai mund ta ketë pësuar, kjo nuk nënkupton heqje të kësaj të drejte. Përveç kësaj, çdo pohim për keqtrajtim gjithashtu mund të shqyrtohet përmes ankesës së qytetarit apo avokatit të të pandehurit.

Paragrafi 16

Komiteti dëshiron të marrë të dhënat mbi të gjitha ankesat për keqtrajtim nga policia që janë pranuar nga Inspektorati i Policisë së Kosovës në vitin 2007 dhe rezultatit e procedurave relevante disiplinore dhe/ose penale (pohimet, përshtkrim i shkurtër i të gjeturave të gjykatës apo organit relevant, verdiktin, dënimin/sanksionin e shqiptuar);

Që nga 1 tetori 2007 deri më 30 korrik 2008, Departamenti i Hetimeve i Inspektoratit të Policisë së Kosovës ka pranuar 1519 raste, qoftë në formë të ankesave të qytetarëve apo hetimeve të brendshme kundër stafit të Policisë së Kosovës.

Brenda tre muajve nga 1 tetori 2007 deri më 31 dhjetor 2007, Inspektorati i Policisë së Kosovës ka pranuar në përgjithësi 250 raste, nga të cilat 122 kanë qenë ankesa të qytetarëve mbi sjellje të keqe nga zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe 128 inicime për hetime të brendshme (shih tabelën 1).

Tabela Nr. 1. Të dhëna statistikore mbi rastet e Inspektoratit të Policisë së Kosovës

Rastet e pranuar nga Inspektorati i Policisë së Kosovës nga 01.10.07-31.12.07	
Ankesa të qytetarëve	122
Inicime të hetimeve të brendshme	128
Rastet e përgjithshme:	250
Rastet e drejtuara nga Inspektorati i Policisë së Kosovës	
Rastet nën hetime nga Inspektorati i Policisë së Kosovës	40
Rastet nën hetim paraprak	72
Rastet e refuzuara	43
Rastet e referuara Drejtorisë për standarde profesionale	95
Paditë më të shpeshta	
Sjellja e keqe	46
Përdorimi i forcës	30
Mosrespektimi i kohës së pushimit	13
Veprat penale	10
Korrupsioni	6

Inspektorati i Policisë së Kosovës ka pranuar 30 ankesa ku pohohet përdorimi i paligjshëm i forcës. Nga këto ankesa, 17 u refuzuan meqë nuk ishin objektive apo hetimet zbuluan se nuk kanë bazë. Gjashtë raste i janë referuar prapë Drejtorisë mbi standardet profesionale, meqë incidentet kishin ndodhur para 1 tetorit të vitit 2007. Gjashtë raste janë hetuar nga Inspektorati i Policisë së Kosovës dhe sanksionet e rekomanduara duhet të konfirmohen nga Komiteti për Emërime të Larta në Polici dhe për Disiplinë.

Rasti i parë përfshinte pesë zyrtarë të Policisë së Kosovës të cilët e keqtrajtuuan një qytetar gjatë arrestimit të tij dhe pastaj sërish kur ai ishte ulur në veturën e policisë. Inspektorati i Policisë së Kosovës rekomandoi që të suspendohet pa pagesë një polic për 60 ditë, dy policë për 30 ditë dhe dy policë të gjobiten me 20 për qind zbritje nga një pagë mujore.

Dy raste të tjera përfshinin pohime për përdorim disproporcional të forcës nga policët e Policisë së Kosovës gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në Ferizaj dhe në Prishtinë. Në të dyja rastet, Inspektorati i Policisë së Kosovës rekomandoi suspendimin pa pagesë për 60 ditë.

Në një rast të katërt, Inspektorati i Policisë së Kosovës rekomandoi suspendimin pa pagesë për 30 ditë kundër një polici i cili përdori forcë disproporcionale gjatë një arrestimi në Deçan.

Rasti i pestë përfshinte një polic, i ngarkuar për lëndime trupore të kryera jashtë detyrës. Polici është suspenduar pa pagesë deri në fund të hetimeve penale.

Rasti i fundit ka të bëjë me një toger në stacionin e policisë në Vushtrri, për të cilin pohohet se ka keqtrajtuar një të dyshuar pas arrestimit të tij. Inspektorati i Policisë së Kosovës fillimisht rekomandoi suspendimin pa pagesë për 60 ditë. Meqë togeri i njëjtë veç është i suspenduar për akuza të tjera, Inspektorati i Policisë së Kosovës ka rekomanduar shkarkimin e tij nga Policia e Kosovës.

Deri më sot, Departamenti i Hetimeve i Inspektoratit të Policisë ka mbyllur 70 raste dhe një seancë dëgjimore është në pritje për t'u mbajtur nga Komiteti për Emërime të Larta në Polici dhe për Disiplinë. Për shkak të evoluimit të situatës politike në Kosovë, Komiteti për Emërime të Larta në Polici dhe për Disiplinë akoma nuk është bërë operacional. Mirëpo, parashihet që Komiteti të fillojë punën gjatë vitit 2008.

Paragrafi 18

Komiteti dëshiron të marrë të dhëna të detajuara mbi inspektimet e rëndomta apo të jashtëzakonshme që janë bërë nga Inspektorati i Policisë së Kosovës që nga prilli 2007 (objektivat, konkludimet, etj.);

Nga prilli i vitit 2007 deri në fund të vitit, Inspektorati i Policisë së Kosovës ka bërë shtatë inspektime të rëndomta.¹⁰ Inspektimet janë bërë në këto fusha:

¹⁰ Për informacione të detajuara mbi inspektimet e rëndomta të kryera që nga fillimi i vitit 2007 ju lutemi t'i referoheni raportit vjetor të Inspektoratit të Policisë së Kosovës 2007, që i është bashkëngjitur kësaj përgjigjeje.

Menaxhimi i buxhetit dhe financave;
Menaxhim i karrierës;
Menaxhimi i trafikut rrugor;
Menaxhimi i parkut të automjeteve;
Menaxhimi i ndërtesave dhe
Arrestimi dhe paraburgimi.

Një inspektim i jashtëzakonshëm është kryer lidhur me sjelljen e Policisë së Kosovës gjatë trazirave civile më 10 shkurt të vitit 2007, a janë veprimet e Policisë së Kosovës në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54 mbi kornizën dhe parimet udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës të datës 20 dhjetor 2005, dhe menaxhimin e laboratorit të mjekësisë ligjore të Policisë së Kosovës. Të dhënat e detajuara mbi inspektimet e jashtëzakonshme mund të gjenden në raportin vjetor të sipërpërmendur të vitit 2007.

Inspektimi i jashtëzakonshëm më 10 shkurt 2007 kishte për qëllim të vlerësojë punën e zyrtarëve të lartë të Policisë së Kosovës të cilët ishin përgjegjës për policët e Policisë së Kosovës në detyrë në Rrugën “Nënë Tereza” gjatë trazirave atë ditë. Në veçanti, Inspektorati i Policisë së Kosovës e vlerësoi menaxhimin e policëve të Policisë së Kosovës nga mbikëqyrësit e tyre, planifikimin që ishte bërë para ngjarjes lidhur me komandën dhe kontrollin, si dhe mësimet që i kishin mësuar.

Për këtë inspektim, informacionet janë marrë nga burime të ndryshme, siç janë intervistat me policët e Policisë së Kosovës të të gjitha gradave si dhe nga videomaterialet e incizuara. Inspekcioni konstatoi se policët e Policisë së Kosovës nuk ishin të pajisur me mjetet e domosdoshme për t'u përballur me trazirat, siç janë gazmaskat, kutitë e gazit lotsjellës ose cisternat e ujit. Policët e Kosovës gjithashtu nuk ishin të pajisur me revole dhe plumba plasës prej gome, siç ishin ato që, sipas hetimeve të mjekësisë ligjore, shkaktuan vdekjen e dy personave. Njësitë e Policisë së UNMIK-ut ishin njësitë e vetme të pajisur me kutia të gazit lotsjellës si dhe revole dhe plumba gome.

Për më tepër, Inspektorati i Policisë së Kosovës konfirmoi se Njësisë rajonale për mbështetje operative të Policisë së Kosovës nuk i ishte ofruar trajnim adekuat për t'i aftësuar ata që të merren me rastet e trazirave. Në disa rajone, Njësisë rajonale për mbështetje operative i ishte ofruar modeli “danez” i trajnimit për trazira të popullatës civile. Në rajone të tjera, siç është Peja, njësitë rajonale për mbështetje operative ishin trajnuar sipas modelit të Karabinierëve italian, që u dëshmuua veçanërisht i suksesshëm për trajtimin e trazirave të popullatës civile dhe kontrollimin e turmave. Pas rekomandimeve të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, njësitë speciale të Policisë së Kosovës tani u nënshtrohen trajnimit sipas modelit të Karabinierëve italian. Përveç inspekcionit të sipërpërmendur për sjelljen e Policisë së Kosovës, Inspektorati i Policisë së Kosovës gjithashtu është autorizuar të vëzhgojë hetimin e UNMIK-ut për vdekjen e dy civilëve lokal gjatë ngjarjeve të 10 shkurtit 2007. Task Force e UNMIK-ut që drejton hetimet konfirmoi se të dy burrat vdiqën si rezultat i drejtpërdrejt i përdorimit të plumbave të gomës të cilët janë gjuajtur për të shpërndarë turmat. Është bërë autopsia nga një ekip i ekspertëve ndërkombëtarë dhe kosovarë. Plumbat e gjetur

në trupat e viktimave janë klasifikuar si plumba “RB1”. Task Force konstatoi se gjatë demonstratave të 10 shkurtit 2007, plumbat RB1 ishin përdorur vetëm nga një ekip, që përbëhej nga nëntë polic, nga Njësia e formuar e policisë rumune.

Paragrafi 20

Komiteti dëshiron të njoftohet për masat konkrete të ndërmarra nga autoritetet relevante për hetimet e paraqitura në paragrafët 19 dhe 20, me qëllim të parandalimit të ndodhjes së incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

Në frymën e hetimeve për ngjarjet e shkurtit, Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut lëshoi një udhëzim për të gjitha njësitë e formuara të policisë duke i udhëzuar ata që të mos përdorin plumba të gomës në ngjarjet e rendit publik dhe të sigurojnë tërheqjen e plumbave të gomës nga uzinat e tyre të armëve. Si pasojë e drejtpërdrejtë e ngjarjeve të shkurtit, janë tërhequr të gjitha plumbat e gomës nga UNMIK-u, meqë u dëshmuua se ata kanë pasojë vdekjeprurëse.

Inspektimi i Inspektoratit të Policisë së Kosovës për sjelljen e policëve të Kosovës gjatë ngjarjeve të 10 shkurtit të vitit 2007 demonstroi se mungesa e bashkëpunimit në mes të njësive të ndryshme policore, dhe mungesa e pajisjeve adekuate e vështirësoi kryerjen efikase të detyrave të njësive rajonale për mbështetje operative. Këto probleme janë zgjidhur. Aktualisht, të gjitha njësitë speciale të Kosovës u nënshtrohen trajnimeve të njëjta, duke u bazuar në modelin e Karabinierisë italiane.

Rekomandimet e Inspektoratit të Policisë së Kosovës kanë ndihmuar Policinë e Kosovës në menaxhimin e demonstratave të cilat u mbajtën pas 10 shkurtit 2007, dhe parandaluan incidentet e ngjashme.

Nga perspektiva e Policisë së UNMIK-ut, mësimet e mësuara gjatë ngjarjeve të 10 shkurtit 2007 shërbyen për të përmirësuar bashkëpunimin brenda forcave përkatëse në terren. Veçanërisht, është përforcuar komunikimi në mes të Policisë së Kosovës, njësive të formuara të policisë dhe KFOR-it. Për më tepër, Policia e UNMIK-ut përmirësoi standardet e punës së Policisë së Kosovës duke mbajtur trajnime të unifikuara, duke i aftësuar ata që në mënyrë efikase t'i trajtojnë trazirat dhe të kontrollojnë turmën.

Mbrojtja

Paragrafi 26

Komiteti rekomandon ndërmarrjen e masave për të siguruar që të gjithë personat të cilët janë të obliguar të qëndrojnë në polici gëzojnë të drejtën e qasjes në avokat, që në fillim të privimit të tyre nga liria;

Ministria e Punëve të Brendshme, e cila është në dijeni për rekomandimet e Komitetit, pajtohet për rëndësinë e sigurimit të qasjes në avokat nga fillimi i privimit të personit nga liria si një mbrojtje fundamentale kundër keqtrajtimit.

Në këtë aspekt, ligji në fuqi siguron të drejtën për personin e arrestuar që atij t'i ofrohet ndihma e mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij si dhe të informohet për këtë të

drejtë.¹¹ Kjo është e detajuar në Doracakun për procedurat dhe politikat, i cili parasheh që personi i arrestuar të informohet gojarisht nga polici për të drejtën e tij në ndihmë të mbrojtësit me rastin e arrestimit. Përveç kësaj, pas arritjes në stacionin e policisë, personi i arrestuar gjithashtu informohet për të drejtat e tij në formë të shkruar kur ai e merr dhe e nënshkruan formën “Të drejtat e personit të arrestuar”. Forma e nënshkruar i bashkëngjitet dosjes së rastit të personit. Në pajtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës ¹² dhe me Doracakun mbi politikat dhe procedurat, personi i arrestuar gjithashtu informohet për të drejtën e tij në mbrojtës pa pagesë, nëse personi nuk ka mundësi të paguaj për ndihmën juridike.¹³

Vetëm në raste të veçanta autoriteteve u lejonet të intervistojnë personin e arrestuar para se të arrij mbrojtësi. Rastet e tilla të veçanta janë të bazuara në arsye të justifikueshme për të konkluduar se informacionet e marra nga personi i arrestuar do të mundësonin që të shpëtohet jeta e një personi tjetër. Sipas Doracakut mbi politikat dhe procedurat, “një intervistë e tillë do të zhvillohet vetëm me qëllim të marrjes së informacionit të tillë. Edhe në raste të tilla, të drejtat e personit të arrestuar nuk do të cenohen dhe, me rastin e arritjes, mbrojtësit do t’i mundësohet qasje e menjëhershme tek personi i arrestuar.”

Për më tepër, në raste të veçanta, e drejta për mbrojtje të avokatit nga koha e arrestimit mund të vonohet deri në 24 orë sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës “kur personi i arrestuar dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar dhe prokurori apo gjyqtari hetues kompetent konstaton se vonesa kërkohet për shkak të nevojave të veçanta të hetimit të rastit. Prokurori apo gjyqtari hetues kompetent, para skadimit të periudhës së parë të vonesës deri në 24 orë mund të konstatojë se nevojitet edhe një vonesë tjetër prej 24 orë për shkak të nevojave të veçanta të hetimit të rastit.”¹⁴

Të gjithë komandantët e stacioneve të policisë kanë qenë të informuar me udhëzimet e dërguara në tetor të vitit 2007 për nevojën e respektimit të së drejtës së personit të arrestuar në ndihmë ligjore. Me paraqitjen e formës “Të drejtat e personit të arrestuar” si dhe aplikimin e Doracakut mbi politikat dhe procedurat, janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar respektimin e kësaj të drejte.

Paragrafi 27

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet policore për të siguruar që të gjitha kontrollimet mjekësore të personave të paraburgosur të bëhen pa praninë e policëve dhe pa i dëgjuar policët – përveç nëse mjeku në fjalë në raste të veçanta kërkon ndryshe;

Ministria e Punëve të Brendshme pajtohet që të gjitha kontrollimet mjekësore të bëhen në një atmosferë të konfidencialitetit. Kjo është e paraqitur në Procedurën

¹¹ Neni 12, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, 6 korrik 2003.

¹² Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26.

¹³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga autoritetet për zbatimin e ligjit, 11 tetor 2001, Doracakut mbi procedurat dhe politikat e Shërbimit Policor të Kosovës 2007, Numri i rregullës 4-11.

¹⁴ Paragrafi 3.7, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/28, mbi të drejtat e personave të arrestuar nga autoritetet për zbatimin e ligjit, 11 tetor 2001.

standarde të veprimit “Qendrat e mbajtjes”¹⁵ të cilat merren me trajtimin e personave të paraburgosur dhe ju përmbahen parimit të konfidencialitetit.

Paragrafi 29

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia – për çfarëdo arsye – të informohen plotësisht për të drejtat e tyre fundamentale (duke përfshirë edhe të drejtën për të pasur qasje tek mjeku) që në fillim të privimit të tyre nga liria (d.m.th. nga momenti kur ata obligohen që të qëndrojnë me policinë). Kjo duhet të sigurohet me sigurimin e informacioneve të qarat të dhëna gojarisht që në fillim të ndalimit, dhe të plotësuar në rastin e parë të mundshëm (d.m.th. menjëherë pas hyrjes në lokalet e policisë) duke ju siguruar një fletë me shkrim, ku janë shënuar të drejtat e personave të ndaluar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo fletë duhet të jetë në dispozicion në disa gjuhë përkatëse. Më tutje, personat në fjalë duhet të nënshkruajnë një deklaratë me të cilën dëshmojnë se janë njoftuar mbi të drejtat e tyre;

Që nga vizita e delegacionit të Komitetit, situata lidhur me informimin e personave të ndaluar mbi të drejtat e tyre fundamentale është përmirësuar dukshëm. Pas arrestimit, personat njoftohen mbi të drejtat e tyre gojarisht. Këto të drejta përsëriten me shkrim në formën “Të drejtat e personit të arrestuar”, në dispozicion në shqip, serbisht dhe anglisht, që e merr dhe e nënshkruan personi i arrestuar pas arritjes në qendrën e mbajtjes.

Forma “Të drejtat e personit të arrestuar ” përfshin si vijon:

Listën e të drejtave në një gjuhë zyrtare të cilën e njeh personi i ndaluar;
Të drejtën në ndihmë ligjore;
Të drejtën për të kërkuar kontrollim mjekësor nga një mjek sipas zgjedhjes së tij dhe
Të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes.

Personat e arrestuar me prejardhje të huaj kanë të drejtë të njoftojnë dhe të komunikojnë me zyrat e ndërlidhjes apo me misionet diplomatike të shtetit të tyre, apo të njoftojnë dhe të komunikojnë me një përfaqësues nga një organizatë kompetente ndërkombëtare, në rastet kur i paraburgosuri është refugjat.

Paragrafi 33

Komiteti rekomandon që, në stacione të policisë në Kosovë, të hapet dosje e veçantë gjithëpërfshirëse e ndalimit për çdo person të paraburgosur;

Ministria e Punëve të Brendshme si dhe menaxhmenti i Policisë së Kosovës kanë potencuar rëndësinë e madhe të hapjes dhe mbajtjes adekuate të dosjeve të ndalimit. Në këtë aspekt janë arritur përmirësime të konsiderueshme dhe që nga tetori i vitit 2007 të gjitha stacionet e policisë në Kosovë përdorin format e njëjta të dosjeve të ndalimit.

¹⁵ Departamenti i Shërbimit Policor të Kosovës për Rend Publik dhe Paqe, *Procedurat standarde të veprimit*, DRP/DPZH/0278/07, 2007.

Ndryshimi në procedurën standarde të veprimit “Qelitë e mbajtjes”, parasheh vendosjen e tri formave vijuese të standardizuara në dosjen e personit të paraburgosur pas pranimit në qendrën e mbajtjes:

- Të drejtat e personit të arrestuar;
- Vendimi për personin e arrestuar dhe
- Vendimi për lirimin e personit të arrestuar.

Këto forma janë në dispozicion në intranetin e Shërbimit Policor të Kosovës në shqip, serbisht dhe anglisht dhe të gjithë policët e Shërbimit Policor të Kosovës janë trajnuar se si duhet plotësuar saktësisht këto forma.

Për më tepër, hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar që:

- **dosja e ndalimit është dërguar me të paraburgosurin kur ai transferohet në një stacion tjetër të policisë, ku një kopje ruhet në stacionin e parë të policisë;**

Qendrat rajonale të ndalimit u raportojnë stacioneve rajonale të policisë mbi personat e paraburgosur çdo mëngjes. Për më tepër, menaxhmenti i Policisë së Kosovës ka zbatuar rekomandimin e Komitetit sa i përket transferimit të dosjeve të ndalimit. Në rastin kur personi i paraburgosur transferohet, dosja e ndalimit dërgohet me personin dhe një kopje ruhet në stacionin e policisë.

- **Kërkesa për të hapur dosje të ndalimit zbatohet nga momenti kur i paraburgosuri arrin në stacionin e policisë (d.m.th. edhe gjatë gjashtë orëve të para të paraburgimit, para se prokurori të autorizojë paraburgimin deri në 72 orë);**

Si rregull, dosjet e ndalimit tani hapen pas ardhjes së personit në stacionin e policisë.

Sa i përket stacionit policor të Prishtinës nr. 2, ky stacion nuk është i pajisur me qeli të mbajtjes. Prandaj, personat e arrestuar nga grupi i krimeve që ndodhen në stacionin nr. 2, të cilët merren vetëm me krime serioze, dërgohen në stacionin e policisë nr. 1 për regjistrim dhe paraburgim. Të gjitha dosjet e ndalimit vendosen në stacioni policor nr. 1. Të paraburgosurit dërgohen në stacionin policor nr. 2 vetëm për t’u marrë në pyetje, më së shumti dy orë për një herë. Shënimet ku detajisht shënohet data dhe koha e marrjes në pyetje gjithashtu ruhen në stacionin policor nr. 1.

Menaxhmenti i Policisë së Kosovës e din se kjo situatë duhet të përmirësohet. Prandaj, me një projekt të ri për renovim dhe rindërtim parashihet që çdo qendër e mbajtjes të jetë gjithashtu e pajisur me dhoma të intervistimit.

- **Kërkesa për të hapur dosje të ndalimit zbatohet edhe në stacionet e policisë pa objekte të paraburgimit por ku së pari mbahen të dyshuarit me qëllim të intervistimit të tyre.**

Menaxhmenti i Policisë së Kosovës është në dijeni se mbajtja e personave deri në gjashtë orë në stacione të policisë të cilët nuk janë të pajisur në mënyrë adekuate për

këtë qëllim ngrit disa shqetësime, kryesisht për të respektuar kërkesën për hapjen e menjëhershme të dosjes së ndalimit për personin e arrestuar. Stacionet e policisë të cilët nuk kanë hapësirë për qelitë e mbajtjes janë identifikuar dhe do të ndërmerren hapa që personat e arrestuar të transferohen drejtpërsëdrejti në stacionet me kapacitete të mjaftueshme.

Paragrafi 28

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave mjekësore në të gjitha institucionet policore;

Ministria e Punëve të Brendshme pajtohet se duhet të sigurohet konfidencialiteti i të dhënave mjekësore. Mirëpo, Ministria mendon se të dhënat mjekësore trajtohen me kujdesin e nevojshëm. Të gjitha raportet mjekësore vendosen në dosjen e ndalimit/paraburgimit të personit, të cilat mbesin konfidenciale. Vetëm zyrtari i bazës së të dhënave në stacionin e policisë ka qasje në këto dosje. Ekziston një metodë e sigurt dhe efikase e ruajtjes së shënimeve.

Paragrafi 30

Komiteti rekomandon ndërmarrjen e hapave për t'i dhënë fund praktikës së intervistimit të të dyshuarve si "dëshmitarë" pa i informuar ata mbi të drejtat e tyre;

Ministria e Punëve të Brendshme bën me dije se Inspektorati i Policisë së Kosovës nuk ka hasur në këtë problem gjatë inspektimeve të tij, dhe as nuk ka pranuar ankesa lidhur me këtë. Megjithatë, menaxhmenti i Policisë së Kosovës do të jetë i kujdesshëm ndaj kësaj çështje për të parandaluar çdo shkelje të ligjit në fuqi.

Paragrafi 31

Si rregull, objektivi afatgjatë duhet të jetë zhvillimi i intervistave vetëm në stacione të policisë me objekte të paraburgimit.

Njësia e inspektimeve të brendshme e Policisë së Kosovës, si dhe Komiteti i Njesisë së UNMIK-ut për parandalimin e torturës paraqitën nevojën për dhoma adekuate të intervistimit. Ky rekomandim është përfshirë në projektin e përgjithshëm për renovim dhe ndërtim, i implementuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për të ofruar shërbime për projektet.

Ky projekt parasheh në veçanti ndërtimin e dhomave adekuate për intervistim në çdo qendër të mbajtjes. Rëndësi do t'i kushtohet sigurisë, madhësisë, ndriçimit dhe ventilimit të këtyre dhomave.

Kushtet e paraburgimit

Paragrafi 37

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa pa vonesë që të sigurohet përmirësimi i dukshëm i kushteve materiale të paraburgimit në stacionet e vizituara të policisë (dhe, nëse është e nevojshme, në objekte të tjera të paraburgimit në polici në Kosovë), veçanërisht, sa i përket qasjes në dritë natyrale, ventilim dhe higjienë;

Që nga vizita e Komitetit, janë përmirësuar shumica e qelive të mbajtjes në stacionet e Policisë së Kosovës sa u përket kushteve higjienike. Gjatë një periudhe tremujore, Komiteti i Njesisë së UNMIK-ut për parandalimin e torturës ka bërë vizita ditore së bashku me pjesëtarët e Policisë së Kosovës në stacione të Policisë së Kosovës të zgjedhura rastësisht. Njësia e UNMIK-ut, e cila u shpërbë pasi që e përmbushi detyrën e saj, gjeti dhe dokumentoi përmirësime lidhur me kushtet materiale të qelive të mbajtjes, dhomave të intervistimit, unifikimit të dokumenteve, shërbimeve mjekësore dhe shujtave. Në disa stacione u konstatua se ka nevojë për përmirësime në mbajtjen e kushteve standarde higjienike dhe ato u përfshin në projektin për renovim.

Veçanërisht, në stacionin e policisë në Shtime, është ndërtuar një qeli e re e mbajtjes. Pas instalimeve të kamerave televizive me qark të mbyllur së shpejti do të bëhet operacionale.

Gjithashtu, në stacionin e policisë në Gjilan, mësuam se qelitë e mbajtjes ishin shumë të vogla për të paraburgosur personat e arrestuar. Aktualisht, është duke u ndërtuar një objekt i ri, që do të shërbejë si stacion i policisë dhe qendër e mbajtjes.

Paragrafi 37

Më tutje, Komiteti rekomandon që autoritetet të zhvillojnë një plan të detajuar për të rinovuar progresivisht të gjitha objekte policore të paraburgimit në Kosovë.

Një vlerësim i 28 qendrave policore të mbajtjes, që është bërë prej korrikut deri në nëntor 2007, konstatoi nevojën për përmirësim dhe u hartua një projekt për rinovim dhe ndërtim me objektivat vijuese:

- a. Ndërtimi i pesë qendrave të mbajtjes;
- b. Rinovim i 15 qendrave ekzistuese të mbajtjes;
- c. Eliminim i të metave të vogla në qendrat e mbajtjes që veç janë rinovuar dhe
- d. Sigurimi i pajisjeve për stafin e përhershëm në qendrat e mbajtjes, sidomos në qendrat e mbajtjes që pranojnë numër të madh të personave të arrestuar, dhe me mjete moderne adekuate për të ndaluar të paraburgosurit me rrezik të lartë.

Ky projekt është miratuar në prill të vitit 2008 dhe ftesat për tender veç janë shpallur. Lejet e ndërtimit janë marrë për qendrat e mbajtjes në Gjilan, Podujevë, Lipjan, Viti dhe Obiliq. Implementimi i këtij projekti do të bëhet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara që ofron shërbime për projektet.

Paragrafi 35

Sipas mendimit të Komitetit, qelitë që kanë rreth 2.5 m² (siç janë ato që janë gjetur në stacionin policor në Deçan) duhet të përdoren vetëm për qëllime të mbajtjes së përkohshme, për jo më shumë se disa orë, dhe asnjëherë të mos përdoren për akomodim gjatë natës.

Pas vizitës së Komitetit, qendrat e mbajtjes në stacionin policor në Deçan janë mbyllur dhe më nuk janë në përdorim.

Çështje të tjera

Paragrafi 38

Sipas mendimit të Komitetit, ngushëllimi në prangosjen e personave të paraburgosur në objekte fikse nuk është e pranueshme nëse masat e tilla zbatohen për një periudhë të zgjatur apo para syve të të tjerëve. Për më tepër, nuk mund të ketë arsytim për përdorimin e prangave derisa i dyshuari merret në pyetje. Më gjerësisht, prangat nuk duhet të përdoren si zëvendësim i objekteve të duhura të mbajtjes.

Prangosja e personave të paraburgosur në objekte fikse është praktikë e dënueshme dhe nuk tolerohet nga menaxhmenti i Policisë së Kosovës, kjo dhe përdorimi i drejtë i prangave janë të rregulluar në Doracakun mbi politikat dhe procedurat.¹⁶

Paragrafi 39

Komiteti dëshiron të merr komentet e UNMIK-ut lidhur me ekspozimin e simboleve politike të vërejtura nga delegacioni në stacionin policor të Prishtinës nr. 1.

Komiteti i Njësisë së UNMIK-ut mbi parandalimin e torturës ka shënuar lokacionet ku janë gjetur simbolet apo materialet politike dhe stafi mbikëqyrës i Policisë së Kosovës është njoftuar se këto simbole apo materiale duhej të hiqeshin.

UNMIK-u është njoftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme se janë hequr këto simbole politike nga stacioni policor i Prishtinës nr. 1.

Institucionet nën autorizimin e Ministrisë së Drejtësisë

B. Institucionet ndëshkimore

Keqtrajtimi

Paragrafi 42

Komiteti rekomandon që menaxhmenti në burgun e Dubravës, në qendrën korrektuese në Lipjan dhe në qendrën e paraburgimit në Prishtinë të përkujtojnë stafin e tyre se të gjitha format e keqtrajtimit të personave të burgosur (duke përfshirë edhe abuzimin verbal) nuk janë të pranueshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat;

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi korrektues i Kosovës, të cilat janë të njoftuar me rekomandimet e Komitetit, pajtohen se është e një rëndësie të madhe që të mbështeten dhe të respektohen të drejtat e personave të paraburgosur dhe të burgosurve. Në këtë

¹⁶ Doracaku mbi politikat dhe procedurat e Shërbimit Policor të Kosovës 2007, numri i rregullës 4-19.

aspekt, është nxjerrë një udhëzim i shkruar në vitin 2007 për drejtorët e të gjitha objekteve korrektuese, duke i përkujtuar ata se keqtrajtimi i personave të paraburgosur apo të burgosur është i papranueshëm, në pajtim me Ligjin mbi ekzekutimin sanksioneve penale,¹⁷ dhe Procedura standarde mbi veprimet nr. 6.2 “Përdorimi i forcës”, dhe se sjellja e tillë do të sanksionohet.

Më tutje, në kuadër të trajnimeve institucionale për stafin e shërbimit korrektues të Kosovës, kurset mbi të drejtat e njeriut, të drejtat e personave të burgosur, rregullat kundër keqtrajtimit dhe veçanërisht mbi rregullat evropiane të burgut janë të detyrueshme. Çdo vit, ndërmjet 120 dhe 180 punonjësve të shërbimit korrektues të Kosovës u ofrohet trajnim në qendrën kosovare për edukim mbi sigurinë publike dhe zhvillim.

Në këtë drejtim, me legjislacionin ekzistues, me procedurat standarde operacionale, si dhe me ekzistimin e një planprogrami për trajnime të detyrueshme, tërë stafit të shërbimit korrektues të Kosovës u dërgohet një porosi e qartë se keqtrajtimi i personave të paraburgosur është i papranueshëm dhe se do të sanksionohet në përputhje me rrethanat.

Paragrafi 44

Komiteti rekomandon që të bëhet një hetim i pavarur lidhur me incidentin nga paragrafi 44, lidhur me pohimin e keqtrajtimit/përdorimit të tepruar të forcës nga pjesëtarët e Njësisë së intervenimit në burgun e Dubravës dhe, nëse është e nevojshme, të shqiptohen sanksione adekuate në të gjitha nivelet;

Lidhur me rastin e përshkruar në paragrafin 44, Shërbimi Korrektues i Kosovës i ka marrë këto pohime shumë seriozisht dhe u bënë dy hetime: njëri nga Drejtoria qendrore, i dyti nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës. Nga të dy hetimet u konkludua se Njësia e intervenimit nuk kishte keqtrajtuar apo përdorur forcë të tepruar.

Më 22 shkurt 2007, ndodhi një përleshje në mes të dy personave të burgosur, të cilën e pa Drejtori i burgut të Dubravës si dhe shefi i sigurimit. Nga Njësia e intervenimit është kërkuar ndihma për të ndarë dy personat e burgosur. I burgosuri i cili ishte sulmuar ishte dërguar në spitalin e burgut për trajtim mjekësor. Si masë disiplinore, personi sulmues ishte izoluar për 15 ditë.

Pas një hetimi të detajuar, bazuar në intervistat me dëshmitarët dhe me palët e involvuara, as Ombudspersoni as Drejtoria qendrore nuk konstatuan se është bërë keqtrajtimit apo është përdorur forcë e tepruar.

Si rregull e përgjithshme dhe sipas Procedurës për veprime standarde nr. 6.2 “Përdorimi i forcës”, të gjitha incidentet për përdorim të forcës rishqyrtohen në burg dhe në shtabin e përgjithshëm. Në rastet e përdorimit të tepruar të forcës, hapet hetim i brendshëm, dhe varësisht nga rasti, mundësisht edhe një hetim i jashtëm.

Paragrafi 50

¹⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/46 për Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, 2005.

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa të menjëhershëm në burgun e Dubravës dhe në Qendrën korrektuese në Lipjan për të siguruar që, çdoherë kur ka pohime për keqtrajtim pas një intervenimi nga Njësia e intervenimit, të bëhet një hetim i menjëhershëm (pa cenuar hetimet që do të bëhen nga autoritetet administrative dhe/ose gjyqësore). Për më tepër, udhëheqësit e ekipeve duhet përpiluar raporte të detajuara të intervenimit pas çdo intervenimi;

Që nga fillimi, Shërbimi Korrektues i Kosovës dëshiron që të bëjë me dije se pas një incidenti ku është përdorur forca apo pajiset e shtrëngimit, të gjithë pjesëtarët e involvuar të stafit duhet të paraqesin një deklaratë/raport vrojtimi. Sipas procedurës për veprime standarde nr. 6.2 "Përdorimi i forcës", dokumentet vijuese duhet të kompletohen dhe të grumbullohen nga mbikëqyrësit e lartë pas çdo incidenti të tillë:

- Raportin për përdorimin e forcës;
- Deklaratën/raportin e vrojtimit nga çdo pjesëtar i involvuar i stafit dhe
- Raportin mbi kundërvajtjen, kur është e mundshme.

Të gjitha incidentet ku kemi të bëjmë me përdorim të forcës rishqyrtohen në të dyja nivelet, në burg she në shtabin e përgjithshëm. Komisioneri i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Drejtori i burgut mund të urdhërojnë hetime të incidenteve nëse faktet e kërkojnë një gjë të tillë.

Sa i përket rastit të përshkruar në paragrafin 46, menaxhmenti i Shërbimit Korrektues të Kosovës bëri përpjekje që të gjejë dëshmi për të provuar pohimet. Sa i përket të miturit i cili pohon të ketë pësuar frakturë të dorës së tij, nuk u gjet asnjë shënim në të dhënat e tij mjekësore në Shërbimin Korrektues në Lipjan, as nuk u gjet ndonjë indikacion lidhur me transferimin e tij në spitalin e Prishtinës. Dora e thyer nuk mund të kalonte pa u vërejtur dhe në raste të tilla trajtimi do të ishte i detyruar.

Duke ditur se mungojnë dëshmitë, nuk dihen emrat e të miturve dhe nuk kemi të dhëna mjekësore, menaxhmenti i Shërbimit Korrektues të Kosovës vetëm mund të konkludojë se ky incident nuk ka ndodhur ashtu si i është treguar delegacionit të Komitetit. Shërbimi Korrektues i Kosovës shpreh keqardhjen pse këto pohime nuk kanë mundur të hetohen detajisht dhe fton Komitetin që të ndajë informacione të tjera të cilat ka mundur t'i merr, për të vlerësuar këtë rast në mënyrë adekuate.

Shërbimi Korrektues i Kosovës i bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të parandaluar keqtrajtimin dhe për të krijuar një mjedis ku mbizotëron ligji brenda objekteve korrektuese. Për të kryer këtë detyrë, Shërbimi Korrektuesi Kosovës mbështetet nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut /Divizioni për menaxhimin e burgjeve, të cilët e kanë mandatin për të vizituar, monitoruar dhe këshilluar. Divizioni për menaxhimin e burgjeve çdo javë bën vizitë monitoruese për të përhapur praktikat e mira brenda institucioneve dhe për t'ju dhënë rekomandime menaxhmentit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Paragrafi 51

Komiteti rekomandon që të gjithë pjesëtarët e Njesisë së intervenimit në burgun e Dubravës dhe në Qendrën Korrektuese në Lipjan të përkujtohen se çdo forcë e përdorur ndaj të burgosurve gjatë intervenimeve duhet të kufizohet deri në atë

që striktivisht është e domosdoshme dhe atë, posa që të burgosurit kokëfortë të sillen nën kontroll, nuk mund të ketë arsytim për goditjen e tyre;

Shërbimi Korrektues i Kosovës dëshiron të potencojë se njësitë e intervenimit duhet të zbatojnë, sikurse stafi tjetër i Shërbimit Korrektues të Kosovës, procedurën për veprime standarde nr. 6.2 “Përdorimi i forcës”, dhe përveç kësaj edhe, procedurën për veprime standarde “Njësia e intervenimit”, bazuar në Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.¹⁸

Është në natyrën e punës së tyre, që pjesëtarët e njësive të intervenimit të mund të përballen me situata ku duhet përdorur forcën. Gjatë intervenimeve, njësitë mund të përdorin teknika të kontrollit dhe zaptimit për t’ju përgjigjur sjelljes agresive ose të dhunshme të personit të burgosur. Për këtë qëllim, njësitë e intervenimit trajnohen që forcën ta përdorin në mënyrë proporcionale dhe ata përkujtohen gjatë këtyre trajnimeve për ndalimin absolut të keqtrajtimit apo abuzimit të personave të burgosur.

Paragrafi 52

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa nga autoritetet relevante për të siguruar që rregullat e parapara në paragrafin 52 të implementohen në praktikë në të gjitha institucionet ndëshkimore në Kosovë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës ishte shumë i shqetësuar me të dëgjuar pohimet për pjesëtarët e njësive të intervenimit të cilët kanë mbajtur maska, të cilat nuk janë pjesë e uniformës së rregullt. Prandaj, të gjithë drejtorëve u janë dërguar udhëzimet e përgjithshme në tetor 2007, duke përkujtuar stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës që të mos përdoren maska në asnjë rrethanë.

Paragrafi 47

Komiteti dëshiron të potencojë se çdo i burgosur ndaj të cilit është përdorur forcë duhet të ketë të drejtë që menjëherë të kontrollohet nga një mjek dhe, nëse është e nevojshme, t’i ofrohet trajtim;

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës dëshirojnë të spikasin se përdorimi i forcës ndaj të burgosurve është marrë seriozisht. Ekzistojnë procedura adekuate për të siguruar që çdo incident i dhunshëm të regjistrohet në mënyrën e duhur.

Procedura për veprime standarde nr. 6.2 “Përdorimi i forcës” parasheh që pas incidenteve ku kemi të bëjmë me përdorim të forcës apo zbatimit të masave të zaptimit, i burgosuri të kontrollohet sa më shpejt që të jetë e mundur nga një mjek. Rezultatet e kontrollimit si dhe çdo përcjellje e kërkuar duhet të dokumentohen në raportin për përdorim të forcës.

Shënimet për incidentin e dhunshëm nuk konsiderohen complete derisa i burgosuri nuk kontrollohet nga një mjek dhe të gjitha raportet nuk hartohen saktësisht.

¹⁸ Nenet 123 dhe 124, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/46 për Ligjin mbi ekzekutimin e saksoneve penale, 2005,.

Paragrafi 50

Komiteti fton autoritetet relevante për të paraqitur një politikë të rotacionit për pjesëtarët e njësive të intervenimit në burg;

Thënë më përgjithësisht, është esenciale që të kushtohet kujdes i madh kur bëhet përzgjedhja, rekrutimi, trajnimi (duke përfshirë menaxhimin e stresit), trajnimin fizik dhe pajisjen e pjesëtarëve të njësive speciale, për t'u siguruar se ata janë më të mirët për t'u marrë me situatat e rrezikut në mënyrë adekuatë (d.m.th. të përdorin forcë minimale).

Derisa koncepti i paraqitjes së politikës së rotacionit për pjesëtarët e njësive të intervenimit në burgje mirëpritet, në rrethanat e veçanta të cilat ekzistojnë në Kosovë kjo mund të mos jetë e mundshme. Pjesëtarët e këtyre njësive rekrutohen përbrenda dhe ata duhet të plotësojnë kushte të caktuara lidhur me moshën e tyre dhe përshtatshmërinë. Rekrutimi bëhet në baza vullnetare meqë detyrat e këtyre njësive janë më të rrezikshme se sa brenda shërbimit të rregullt. Prandaj, vetëm disa pjesëtarë të stafit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dëshirojnë t'u bashkohen këtyre njësive. Kjo e kufizon zgjidhjen e stafit në dispozicion dhe kjo do të ishte sfiduese, nën këto rrethana, të paraqitet politika e rotacionit derisa të ndryshojnë këto rrethana.

Kështu, pjesëtarët e njësive të intervenimit u nënshtrohen trajnimeve të specializuara dhe ata certifikohen. Certifikatat duhet të ripërtërihen çdo tri vjet, obligim ky që shërben për të mbajtur standarde të larta profesionale brenda këtyre njësive, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Përveç trajnimit fillestar bazik, njësitë e intervenimit trajnohen rregullisht; çdo tre muaj mbahen trajnime praktike mbi taktikat brenda hapësirave speciale në burgun e Dubravës. Gjithashtu, çdo objekt i paraburgimit ka një instruktor të brendshëm i cili mban ligjërata teorike për njësitë e intervenimit.

Si pjesë e trajnimit institucional, mbahen orë për menaxhimin e stresit për tërë stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke përfshirë edhe njësitë e intervenimit. Ndonjëherë, përveç trajnimit pa shkëputje nga puna, organizatat joqeveritare gjithashtu mbajnë orë për menaxhimin e stresit.

Kushtet materiale të objekteve të paraburgimit

Paragrafi 54

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa pa vonesë për të rinovuar blloqet në burgun e Dubravës të cilët akoma nuk kanë përfituar nga kjo punë. Përpjekje duhet bërë gjithashtu që të zvogëlohen nivelet e mbajtjes në ato qeli të cilat aktualisht janë përplot; synimi duhet të jetë që të sigurohet së paku 4 m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në qeli për më tepër të burgosur dhe 9 m² hapësirë jetese në qeli të veçanta;

Shërbimi Korrektues i Kosovës pajtohet se burgu i Dubravës ka nevojë për renovim. Meqë objekti është i madh, që nga viti 1999 janë bërë renovime çdo vit. Në këtë aspekt, shumica e blloqeve veç janë rinovuar. Puna në bllokun nr. 5 dhe 7 është

kompletuar në vitin 2008. Rinovimi në bllokun 8 ka mbetur prapa orarit të paraparë por rinovimi vazhdon.

Objektet tjera ndihmëse, siç është hapësira rekreative dhe depoja janë rinovuar. Ferma e bagëtive jashtë portës hyrëse është duke u ndërtuar, si dhe objektet për vizitorë.

Në përgjithësi, objektet e paraburgimit në Kosovë nuk janë të mbipopulluar. Situata në vitin 2007 ishte e përkohshme për shkak të rinovimit të qendrës së paraburgimit në Pejë, e cila u rihap në tetor të vitit 2008. Menaxhmenti i burgut është i kujdesshëm që të burgosurve t'u sigurojë hapësirë të mjaftueshme jetese dhe, gjatë rinovimeve, bëri përpjekje që problemin e mbipopullimit ta zvogëlojë sa më shumë që të jetë e mundshme.

Paragrafi 57

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa adekuat nga autoritetet relevante në njësitë për të mitur dhe femra në Qendrën Korrektuese në Lipjan për të rregulluar mangësitë e përshkruara në paragrafin 57;

Shërbimi Korrektues i Kosovës pajtohet se objektet e paraburgimit duhet të rinovohen dhe të mirëmbahen. Për këtë qëllim, drejtorët e këtyre objekteve mund të paraqesin kërkesë për rinovime në programet ekzistuese të planifikimit. Këto projekte, nëse miratohen, implementohen vitin e ardhshëm.

Lidhur me mbipopullimin në kohën e vizitës së delegacionit të Komitetit, ky ishte problem i përkohshëm. Në përgjithësi, njësitë e femrave nuk janë të nxënë në kapacitete të plota dhe ata nuk kanë problem me mbipopullimin.

Sigurimi i peshqirëve sanitarë, të mjaftueshëm në sasi dhe cilësi, për të burgosurat femra është çështje e dinjitetit njerëzor. Shërbimi Korrektues pajtohet se situata duhej të ndryshonte dhe Komisioneri i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxori një urdhëresë për drejtorin e këtij institucioni për të siguruar që peshqirët sanitarë të sigurohen falas.

Paragrafi 59

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa adekuat nga autoritetet relevante për të rregulluar mangësitë e vërejtura në qendrat e vizituara të paraburgimit (ashtu siç janë përshkruar në paragrafin 58). Në veçanti, duhet ndërmarrë hapa për të siguruar që:

- **Në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe Gjilan, qelitë që kanë ndërmjet pesë dhe gjashtë metra katrorë, të përdoren vetëm për një person;**

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdimisht janë duke bërë përpjekje për të përmirësuar kushtet në qendrën e paraburgimit në Gjilan.

Në anën tjetër, renovimet kanë vazhduar, duke përfshirë edhe renovimin e recepcionit si dhe riparimin e sistemit të nxehjes qendrore. Salla e sporteve është pajisur plotësisht dhe tani është në dispozicion të të burgosurve dhe stafit.

Në anën tjetër, puna e planifikimit veç është autorizuar lidhur me ndërtimin e një qendre të re të paraburgimit në Gjilan. Ky objekt i ri dukshëm do të reduktojë problemet që i ndeshim në qendrën aktuale të paraburgimit.

Sa u përket produkteve për higjienë personale, në kohën e vizitës së Komitetit, furnizues të ndryshëm kanë furnizuar institucionet ndëshkimore. Disa prej institucioneve u pajisën në mënyrë të pamjaftueshme apo jo të rregullt. Ky problem është zgjidhur me një kontratë të përgjithshme. Aktualisht, të gjitha institucionet marrin mallra nga furnizuesi i njëjtë. Kjo siguron që të gjithë të burgosurit të marrin pako standarde, duke përfshirë sapun, pastë dhëmbësh, brisqe të rrojës, krehër dhe shapon, rregullisht. Dyqanet e burgut ofrojnë marka alternative për të burgosurit të cilët preferojnë të blejnë produktet e veta higjienike.

Qendra e paraburgimit në Mitrovicë është rinovuar. Aktualisht, për shkak të situatës politike në veri të Kosovës, shumica e të paraburgosurve janë transferuar në qendra të tjera të paraburgimit dhe në Mitrovicë kanë mbetur vetëm disa të paraburgosur. Në këtë aspekt, problemi i mbipopullimit të cilin e ka vërejtur delegacioni gjatë vizitës së tij më nuk ekziston.

- **Në qendrat e paraburgimit në Pejë dhe Prishtinë, të gjitha qelitë kanë qasje të mjaftueshme në dritë natyrore.**

Qendra e paraburgimit në Pejë është rinovuar tërësisht dhe i plotëson standardet në fuqi.

Janë blerë dy ndërtesa në afërsi të qendrës së paraburgimit si dhe tetë hektarë tokë. Do të bëhet një vlerësim për nevojën e trajnimit profesional për të organizuar dy punëtori në këto objekte. Me këtë pilotprojekt, Shërbimi Korrektues i Kosovës synon të ekzaminojë mundësinë e ofrimit të trajnimit profesional për të paraburgosurit.

Qendra e paraburgimit në Prishtinë është rinovuar disa herë, dhe janë zëvendësuar të gjitha dritaret dhe dyert. Mirëpo, duke ditur kufizimet fizike të institucionit, mundësitë për përmirësime janë të kufizuara.

Është bërë një studim i fizibilitetit dhe është autorizuar puna e planifikimit lidhur me ndërtimin e një burgu të sigurisë së lartë, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Pas përfundimit të këtij projekti të ri, do të ketë më shumë hapësirë në dispozicion në qendrën e paraburgimit në Prishtinë dhe ajo do t'i dorëzohet Policisë së Kosovës, të shfrytëzohet si qendër e mbajtjes.

Paragrafët 54 dhe 59

Komiteti dëshiron të përkujtojë se synimi duhet të jetë që në të gjitha institucionet ndëshkimore të sigurohet së paku 4 m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në qelitë për më shumë banorë dhe 9 m² hapësirë jetese në qelitë e veçuara.

Siç është përmendur më lart, mbipopullimi i burgjeve në përgjithësi nuk është problem në Kosovë. Ky problem mund të paraqitet përkohësisht gjatë renovimeve apo gjatë sezonës së dimrit. Mirëpo, nuk është problem sistematik dhe banorëve u sigurohet hapësirë e mjaftueshme jetese, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Paragrafi 55

Komiteti dëshiron të informohet detajisht për rezultatin e stërvitjes për evakuim gjatë natës nga paragrafi 55, si dhe për masat e ndërmarra më vonë në burgun e Dubravës.

Që në fillim, Shërbimi Korrektues i Kosovës dëshiron të potencojë se, të gjitha institucionet korrektuese kanë plane për raste emergjente dhe për evakuim për raste specifike, siç janë tërmetet, zjarret dhe vërshimet.

Lidhur me stërvitjen e evakuimit gjatë natës në burgun e Dubravës, stërvitja e tillë nuk mund të mbahej, për shkak të sigurisë. Stërvitjet në institucione korrektuese e prishin rutinën dhe ato duhet të implementohen nën kushte të kontrolluara. Kryerja e këtyre stërvitjeve gjatë natës do të rrishte rrezikun e arratisjes apo të incidenteve të dhunshme.

Çelësat vendosen në një vend të sigurt gjatë natës. Mirëpo, në rast të ndonjë situatë emergjente në një bllok, një çelës emergjent për këtë bllok shpejt mund të sigurohet në bllokun fqinj. Çdo bllok ka gjashtë dalje emergjente për të siguar një evakuim efikas dhe të shpejtë. Këto dalje emergjente si dhe pajisjet për luftimin e zjarrit vazhdimisht kontrollohen dhe testohen.

Më tutje, në çdo ndërrim, në çdo objekt korrektues, zyrtarët e caktuar merren me procedurat e të gjitha emergjencave. Këta zyrtarë janë trajnuar nga zjarrfikësit në Qendrën kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim dhe atyre gjithashtu u është ofruar trajnim në sigurimin e ndihmës së parë.

Regjimi

Paragrafi 61

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të zgjeruar dukshëm aktivitetet dhe trajnimet që janë në dispozicion për të burgosurit e burgut të Dubravës. Kujdes i veçantë duhet kushtuar planeve për trajtim individual të të burgosurve dhe regjimit për ata të cilët vuajnë dënime të gjata;

Ministria e Drejtësisë pajtohet se aktivitetet e qëllimshme dhe trajnimet profesionale janë esenciale për të mundësuar rehabilitimin e të burgosurve. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme që të burgosurve t'u sigurohet trajnim adekuat dhe mundësi punësimi. Megjithatë, këto përpjekje po sfidohen nga mungesa e mjeteve. Implementimi i një punëtorie kushton ndërmjet 12,000 dhe 15,000 Euro. Kështu, numri i punëtorive është i kufizuar për shkak të buxhetit.

Aktualisht, rregullat relevante nuk e ofrojnë mundësinë për shitjen e sendeve të prodhuara në burgje. Mirëpo, Ministria e Drejtësisë si dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës janë duke bërë përpjekje për të mundësuar shitjen e mallrave të prodhuara

nga të burgosurit e Dubravës, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për trajnime profesionale.

Përkundër këtyre sfidave, në vitin 2007, 51 të burgosur kanë marrë pjesë në kurset e trajnimit mbi word processing dhe spreadsheet software, 17 të burgosur përfunduan një kurs për kontabilist financiar, 10 të burgosur iu nënshtruan trajnimit profesional për makinistë – saldues si dhe 10 të burgosur për hidraulikë.

Për të mundësuar planifikimin e aktiviteteve të qëllimshme, në burgun e Dubravës është themeluar një panel për punësim dhe trajnim profesional.

Paragrafi 64

Komiteti rekomandon që autoritetet t'i dërgojnë porosi të qartë stafit në burgun e Dubravës, edhe në poste mbikëqyrëse edhe në nivel më të ulët se abuzimi i pozitës së tyre me marrjen apo kërkimin e shpërblimeve nga të burgosurit është e papranueshme dhe se çfarëdo aktesh të kësaj natyre do t'ju nënshtrohen sanksioneve të ashpra. Kjo porosi duhet të përsëritet vazhdimisht dhe në mënyrën e duhur;

Ministria e Drejtësisë është shumë e shqetësuar për favorizimin dhe korrupsionin brenda institucioneve korrektuese dhe po bën përpjekje që të trajtojë problemin. Sipas rekomandimeve të Komitetit, Komisioneri i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerrë një udhëzim për menaxhmentin e institucioneve, duke i përkujtuar ata se klasifikimi i të burgosurve si dhe caktimi i regjimit të tyre duhet të bëhet sipas rregullave dhe rregulloreve në fuqi .

Korrupsioni, por sidomos nepotizmi, është vështirë për t'u dëshmuar. Mirëpo, Shërbimi Korrektues i Kosovës i bart pasojat e nevojshme në rastet e dëshmuara; në vitin 2007, katër zyrtarë u shkarkuan nga puna dhe dy të tjerëve iu dha vërejtje për pohime të korrupsionit.

Veç kësaj, stafi i Shërbimit Korrektues të Kosovës vazhdimisht përkujtohet gjatë trajnimeve dhe takimeve mujore se korrupsioni dhe nepotizmi janë të papranueshme dhe se ata do të sanksionohen në përputhje me rrethanat.

Paragrafi 65

Komiteti rekomandon që të vendosen rregulla dhe kritere transparente në burgun e Dubravës, veçanërisht për regjimin e të paraburgosurve dhe shpërndarjen e të burgosurve. Përveç kësaj, të burgosurit duhet të informohen për këto rregulla dhe kritere përmes kanaleve përkatëse;

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka caktuar kriteret për regjimin e të burgosurve si dhe për planifikimin e dënimit. Këto kritere janë paraqitur në doracakun për rend të brendshëm në çdo institucion korrektues.

Në burgun e Dubravës, të gjithë të burgosurit njoftohen për rregullat dhe kriteret nga punëtorët social, nga stafi korrektues apo menaxhmenti i institucionit.

Sa i përket procesit vendimmarrës, janë themeluar dy panele: një panel përcakton regjimin e të burgosurve, tjetri është përgjegjës për planifikimin e dënimit, për privilegjet dhe vizitën në familje. Këto panele i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe drejtorit të burgut i japin rekomandime. Nëse drejtori nuk pajtohet me rekomandimet e panelit, ai obligohet të njoftojë Komisionerin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për arsyet e tij. Ky sistem siguron transparencë dhe zvogëlon mundësitë për favorizime ose korrupsion.

Paragrafi 68

Komiteti rekomandon që në Burgun e Dubravës të ndërmerren hapa për të hartuar një program të aktiviteteve në bllokun 1 të frymëzuar nga parimet e paraqitura në paragrafët 67 dhe 68;

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës pajtohen se të burgosurve me siguri të lartë duhet t'ju sigurohen aktivitete, duke lehtësuar re-integrimin e tyre në shoqëri. Mirëpo, për shkak të faktit se punëtoritë dhe shkollat janë jashtë perimetrit të sigurisë, kjo kategori e të burgosurve nuk mund të vijojnë trajnimet. Këto probleme do të zgjidhen me ndërtimin e një burgu të ri të sigurisë së lartë.

Prandaj, menaxhmenti implementon një regjim të relaksuar të paraburgimit brenda perimetrave të bllokut 1. Të burgosurve u lejohet shumë më tepër kohë për aktivitete se sa që është e lejuar me ligj. Ata kanë fushë të futbollit, tavolina për pingpong dhe palestër në dispozicion. Të burgosurit mund edhe të kujdesen për kopshtin e bllokut dhe të kultivojnë perimet e tyre.

Ministria është e vetëdijshme se kushtet mund të përmirësohen dhe është e paraparë që brenda burgut të ri me siguri të lartë, të burgosurit do të kenë mundësi të përfitojnë nga trajnimi profesional dhe shkollimi.

Paragrafi 71 dhe 81

Komiteti rekomandon që të rishqyrtohet sistemi i klasifikimit të sigurisë në institucionet ndëshkimore në Kosovë, sipas vërejtjeve të bëra në paragrafët 69 dhe 71;

Që nga fillimi i vitit 2008, Komiteti mbikëqyrës i burgjeve ka qenë nën përgjegjësinë e Shërbimit Korrektues të Kosovës ku Divizioni i UNMIK-ut për menaxhimin e burgjeve ka monitoruar aktivitetet e tij. Për të mbikëqyrur funksionimin e Komitetit mbikëqyrës të burgjeve, Komisioneri i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerrë një urdhëresë për marrjen e planeve mujore të punës si dhe raporteve për rishikimet mujore mbi kategorizimin e të burgosurve.

Aktualisht, ka 19 të burgosur të cilët janë klasifikuar në nivelin e sigurisë "A". Në vitin 2007, katër të burgosurve u është zvogëluar niveli i sigurisë dhe që nga fillimi i vitit 2008, i është ulur një të burgosuri.

Lidhur me ankesat në vendimet e Komitetit për mbikëqyrjen e të burgosurve, rrethanat e sigurisë e interpretojnë një veprim të tillë të pazbatueshëm për të burgosurit e nivelit të sigurisë "A". I burgosuri i klasifikuar nën këtë nivel të sigurisë nuk mund të njoftohet mbi të dhënat që shpjen në marrjen e këtij vendimi.

Për të burgosurit e klasifikuar nën nivelin e sigurisë “E” (rrezik për arratisje), këto rrethana nuk janë të zbatueshme dhe ankesa është e mundshme.

Paragrafët 73 dhe 81

Komiteti rekomandon që autoritetet t’i japin fund politikës së “rotacionit” sistematik të qelisë në burgun e Dubravës dhe në qendrat e vizituara të paraburgimit, bazuar në vërejtjet e bëra në paragrafin 73;

Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk pajtohet se rotacioni i qelisë ndikon negativisht në gjendjen mentale të të burgosurit dhe asnjë dëshmi e tillë nuk mund të konstatohet. Rotacioni i qelisë aktualisht implementohet çdo 28 ditë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës është i bindur se kjo masë ofron siguri në mënyrën më të mirë të mundshme sipas rrethanave aktuale.

Burgu i Dubravës nuk është ndërtuar për të burgosur me siguri të lartë. Blloku 1 ka vetëm kapacitete të zvogëluara dhe rotacioni i qelisë është dëshmuar të jetë masë efektive parandaluese dhe përmirësim i sigurisë.

Paragrafët 75 dhe 80

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të zgjeruar dukshëm aktivitetet dhe trajnimet të cilat janë në dispozicion për të burgosurat femra në qendrën korrektuese në Lipjan dhe për të burgosurit në të gjitha qendrat e vizituara të paraburgimit, dhe, nëse është e mundshme, në qendra të tjera të paraburgimit në Kosovë. Vëmendje e posaçme duhet kushtuar planeve për trajtime individuale për të burgosurit dhe planeve për regjimin e atyre të cilët vuajnë dënime të gjata paragrafët 75 dhe 80);

Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdimisht është duke bërë përpjekje për të zgjeruar aktivitetet në dispozicion për të burgosurit.

Brenda institucioneve korrektuese, ka tri regjime të ndryshme për të paraburgosurit. Çdo i burgosur ka plan individual të trajtimit, i cili detajon regjimin e tij, i përgatitur nga stafi profesional i institucionit, siç janë punëtorët social, mjekët, dhe, nëse është e nevojshme, psikologët.

Në qendrën korrektuese në Lipjan, Shërbimi Korrektues i Kosovës do të hapë një qendër për trajnime profesionale me tri kurse të reja për kuzhinierë, furrtar dhe piceri, në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë. Trajnerët për këto kurse tanimë janë trajnuar. Këto punëtori do të jenë të hapura për gratë e dënuara dhe për të miturit.

Aktualisht, qendra korrektuese në Lipjan tanimë ofron trajnime për profesionale për hidraulikë, elektrikistë, ndërtues dhe rrobaqepësi. Të burgosurit gjithashtu mund të marrin pjesë në orë të aktrimit dhe këndimit. Një sallë për aktivitetet të punës së dorës është në dispozicion për të burgosurit dhe është ndërtuar një fushë e re sportive.

Mirëpo, Ministria është duke bërë përpjekje që të krijojë një kornizë legjislative që do të lejonte shitjen e mallrave të prodhuara në burgun e Dubravës. Sa u përket aktivitetëve në qendrat e paraburgimit, mundësitë janë të kufizuara. Të burgosurit të

cilët e vuajnë dënimin e tyre në qendra të paraburgimit janë të punësuar në fusha që janë esenciale për mirëmbajtjen e qendrës së paraburgimit, siç është kuzhina, vendparkimi, shërbimet për mbajtjen e higjienës dhe larjen e hekurosjes e rrobave. Dënimet për të burgosurit të cilët e vuajnë dënimin e tyre në qendra të paraburgimit nuk duhet të kalojnë tre muaj, sipas Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale¹⁹.

Në përgjithësi, qendrat e paraburgimit nuk janë të ndërtuara për të siguruar punë për të paraburgosurit. E drejta për të punuar për të paraburgosurit e procedurës paraprake gjithashtu nuk është e paraparë në Ligj. Shërbimi Korrektues i Kosovës është i vetëdijshëm se të paraburgosurit mund të rrinë në qendra të paraburgimit për një periudhë të gjatë kohore, dhe kështu atyre u ofron mundësi që të merren me sport, të luajnë lojë të shahut, cic mic (board games), të lexojnë dhe të shikojnë TV.

Paragrafi 80

Komiteti rekomandon që si hap i parë, autoritetet të shohin mundësinë e mbajtjes së dyerve të qelive të hapura gjatë një pjese të ditës në qendrat e vizituara të paraburgimit;

Shërbimi Korrektues i Kosovës dëshiron të potencojë se praktika e mbajtjes së dyerve të qelive të hapura në qendra të paraburgimit rrallë mund të gjendet. Një praktikë e tillë do të varej nga niveli i rrezikut dhe sjellja e të paraburgosurve dhe do të duhej të rivlerësohej periodikisht.

Paragrafi 78

Komiteti rekomandon që të gjendet një zgjidhje alternative e qëndrueshme lidhur me aktivitetet dhe të konsiderohet si çështje prioritare për të burgosurit të cilët vuajnë dënime të gjata me burg në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë.

Është ndërtuar një objekt administrativ në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë, që do të strehojë administratën e institucionit. Zyrat aktuale atëherë do të përdoren për punëtorin dhe trajnime.

Mirëpo, për shkak të situatës aktuale politike, aktivitetet ndërtimore po çalojnë në Mitrovicë. Plani fillestar do të implementohet posa të zgjidhet situata.

Paragrafi 62

Ka ardhur koha për menaxhmentin e burgut të Dubravës që të bëjnë përpjekje që të respektojnë më shumë parimet për shpërndarjen e të burgosurve dhe klasifikimin e tyre, të cilat parime ky menaxhment vet i ka përkrahur.

Shërbimi Korrektues i Kosovës i kushton kujdes të madh zbatimit të parimeve të pranuarra përgjithësisht për shpërndarjen dhe klasifikimin e të burgosurve. Në burgun e Dubravës, tri panele vendosin për regjimin, punësimin dhe planifikimin e dënimit për të burgosurit. Ky mekanizëm siguron që të burgosurit të kenë plan individual të trajtimit.

¹⁹ Neni 11, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/46 për Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, 2005.

Blloku 8, ku delegacioni i Komitetit bisedoi me të burgosurit të cilët vuanin dënime të cilët ndryshonin për nga kohëzgjatja si dhe me të burgosur të moshave të ndryshme, është blloku hyrës. Kur të burgosurit arrijnë në burgun e Dubravës, ata muajin e parë vendosen në bllokun 8, derisa paneli të merr vendim lidhur me regjimin e tyre. Pasi të caktohet plani individual i trajtimit, klasifikimi dhe shpërndarja e të burgosurve bëhet në pajtim me standardet në fuqi.

Paragrafi 72

Komiteti dëshiron t'i merr komentet e UNMIK-ut lidhur me vërejtjet e delegacionit se, në burgun e Dubravës, klasifikimet në nivelin e sigurisë "E" nuk rishikoheshin çdo 28 ditë (në kundërshtim me rregulloret në fuqi) dhe se të burgosurit nuk kanë pasur në dispozicion ndonjë rrugë për të bërë ankesë për kundërshtimin e vendimeve të tilla;

Klasifikimi i të burgosurve në nivelin e sigurisë "E" bëhet nga drejtori i burgut të Dubravës bazuar në informacione të besueshme apo dëshmime mbi mjetet për arratisje. Çdo muaj drejtori ka obligim që të rishikojë këtë klasifikim. Sistemi i rishikimit tani po funksionon dhe, sipas Zëvendëskomisionerit të Shërbimit Policor të Kosovës, të burgosurit kanë mundësi të paraqesin ankesë ndaj vendimit të drejtorit. Mirëpo, akoma nuk është vendosur ndonjë procedurë formale e apelit.

Paragrafi 74

Komiteti dëshiron t'i merr komentet e UNMIK-ut lidhur me vërejtjet e bëra nga Komiteti mbi praninë e policëve ndërkombëtarë në Bllokun 1 në burgun e Dubravës (paragrafi 74);

Me marrjen e përgjegjësive për fusha të caktuara lidhur me menaxhimin e burgjeve nga Departamenti i drejtësisë së UNMIK-ut në Ministrinë e Drejtësisë, disa përgjegjësi të caktuara të UNMIK-ut në kuadër të Divizionit për menaxhimin e burgjeve janë marrë përsipër nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Aktualisht, stafi ndërkombëtarë kanë rol monitorues dhe këshillëdhënës. Për shkak të kësaj pjese të kapaciteteve të monitorimit policët ndërkombëtarë ishin të pranishëm në burgun e Dubravës për një periudhë të shkurtër kohore. Prania e policëve ndërkombëtarë në Bllokun 1 ka kohë që ka përfunduar.

Paragrafi 76

Komiteti dëshiron të informohet mbi hapat konkret që janë ndërmarrë deri tani në qendrën korrektuese në Lipjan për të siguruar trajnim të specializuar për stafin që merret me të mitur.

Shërbimi Korrektues i Kosovës po bën përpjekje që të sigurojë trajnimin e nevojshëm të specializuar për stafin që merret me të mitur. Në Kosovë, aktualisht është shumë vështirë të gjinden trajner adekuat për kurse të tilla. Prandaj, në fillim të vitit 2007, dy punëtorë social dhe një zyrtar korrektues u dërguan jashtë për trajnim të specializuar. Në vitin 2008, shefi i programeve për të mitur dhe mbikëqyrësi i lartë, të cilët punojnë në qendrën korrektuese në Lipjan kanë ndjekur trajnime në Republikën Çeke.

Përveç kësaj, për tre muaj gjatë trajnimit institucional themelor për zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës diskutohet për trajtimin adekuat të të miturve në kuadër të sistemit penal.

Aktualisht, negociatat janë duke vazhduar në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit lidhur me sistemin shkollor në të dy qendrat korrektuese në Dubravë dhe në Lipjan. Qëllimi është që të angazhohen arsimtarë të mjaftueshëm për t'ju mundësuar këtyre institucioneve që të sigurojnë shkollim fillor në Dubravë dhe shkollim të mesën në Lipjan. Kjo masë do të rriste edhe numrin e stafit të cilët janë të specializuar për t'u marrë me të mitur.

Kujdesi shëndetësor

Paragrafi 84

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa të menjëhershëm në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe në Pejë për të rregulluar mungesën e karrigeve dentale dhe pajisjeve të tjera;

Qendra e paraburgimit në Mitrovicë ka qenë e pajisur me karrige dentale, duke përfshirë edhe të gjitha pajisjet në janar të vitit 2008. Dentisti, i cili punon me orar të plotë, tani mund të ofrojë të gjitha shërbimet e nevojshme.

Për shkak të afërsisë së qendrës së paraburgimit të Pejës me atë të Dubravës, të burgosurit dërgohen në Dubravë për trajtim dental.

Paragrafi 85

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në burgun e Dubravës për të siguruar që çdo kërkesë e bërë nga një i burgosur për konsultim mjekësor të dërgohet pa vonesë në shërbimin e kujdesit shëndetësor dhe konsultimet të organizohen në të gjitha blloqet gjatë ditëve të punës (dhe jo vetëm dy herë në javë);

Shërbimi Korrektues i Kosovës po bën të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar shërbime mjekësore të mjaftueshme dhe adekuate në të gjitha institucionet korrektuese.

Në burgun e Dubravës, procedura administrative për konsultime mjekësore është ashtu siç është përshtetur në raportin e Komitetit. Mirëpo, është përgjegjësi ekskluzive e personelit mjekësor për t'i kontrolluar kërkesat. Drejtori njoftohet vetëm nëse ka nevojë për transferim të të burgosurit në spital jashtë institucionit.

Çdo bllok vizitohet dy herë në javë për kujdes mjekësor. Përveç kësaj, një infermiere viziton çdo bllok tri herë në ditë gjatë ditëve të punës, për të shpërndarë barna. Infermierja gjithashtu e merr listën me emrat e të burgosurve të cilët kërkojnë konsultime mjekësore dhe cakton prioritetet. Rastet emergjente, natyrisht, trajtohen menjëherë.

Paragrafi 87

Komiteti rekomandon që prania e një psikiatri në burgun e Dubravës të rritet dhe të jetë ekuivalent me një post me orar të plotë;

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/34, personat të cilët vuajnë nga çrregullime mentale nuk duhet të vendosen në institucione korrektuese.²⁰ Atyre u ofrohet trajtim adekuat në institucionet civile të kujdesit shëndetësor. Një psikiatër është në dispozicion të të burgosurve në qendrat e paraburgimit në rast të çrregullimeve të përkohshme mentale.

Një psikiatër e viziton burgun e Dubravës tri herë në javë dhe mund të thirret në telefon ditët tjera. Aktualisht, nuk ka psikiatër në qendrën e paraburgimit në Pejë. Është shpallur vendi i punës dhe është publikuar dy vite rresht, mirëpo, nuk ka pasur kandidat të interesuar. Shërbimi Korrektues i Kosovës akoma është duke bërë përpjekje që të plotësohet ky vend i punës dhe do të vazhdojë ta publikojë postin.

Një psikiatër nga Divizioni i UNMIK-ut për menaxhimin e burgjeve (pjesëtar i stafit ndërkombëtar) është vendosur në burgun e Dubravës si monitorues dhe këshilltar dhe është në dispozicion për konsultime çdo ditë.

Paragrafi 89

Komiteti rekomandon që autoritetet relevante të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që, në të gjitha qendrat e vizituara të paraburgimit, të burgosurve t'u ofrohet kujdes dental;

Të gjitha qendrat e paraburgimit sigurojnë kujdesin e nevojshëm dental për të burgosurit brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Trajtimi i siguruar përfshin nxjerrjen e dhëmbit, mbushjen madje edhe protezat funksionale. Refuzohen vetëm kërkesat për trajtim kozmetik.

Paragrafi 92

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet ndëshkimore në Kosovë për të siguruar që rregullat e parapara në paragrafin 92 lidhur me kontrollimin mjekësor të të burgosurve të posa arritur dhe regjistrimin e lëndimeve të implementohen plotësisht në praktikë;

Pas vizitës së delegacionit të Komitetit dhe bazuar në rekomandimet e tij, kontrollimi mjekësor dhe regjistrimi i lëndimeve janë përmirësuar dukshëm. Aktualisht, është hapur një dosje mjekësore për çdo të burgosur që vjen brenda 24 orëve, që përfshin rezultatet e një kontrollimi të detajuar mjekësor. Nëse personi ka njolla të mavijosura, ato regjistrohen dhe fotografohen.

Procedura e njëjtë zbatohet pas çdo incidenti të dhunshëm. Çdo gjë regjistrohet në dosjen mjekësore të personit të burgosur. Që nga korriku i vitit 2007, çdo institucion korrektues gjithashtu mban dosje speciale ku regjistrohen lëndimet.

²⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/34 mbi procedurën penale ku kemi kryerës të veprave penale me çrregullim mental, 24 gusht 2004.

Dosjet mjekësore i lihen në dispozicion të paraburgosurit me kërkesë të tij, avokatit të tij dhe familjes.

Paragrafi 92

Komiteti rekomandon që të rishikohen procedurat ekzistuese për të siguruar që, çdoherë kur regjistrohen lëndimet nga mjeku të cilat janë konsistente me pohimet e keqtrajtimit të paraqitura nga një i burgosur, këto regjistrime vazhdimisht t'i paraqiten prokurorit relevant;

Në raste të pohimeve për keqtrajtim, stafi mjekësor raporton tek menaxhmenti i institucionit dhe Drejtorisë qendrore, që inicion hetime dhe e njofton policinë. Pastaj policia është ajo që duhet ta njoftojë prokurorin.

Paragrafi 92

Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar që të burgosurit e posa arritur të kontrollohen për sëmundje të transmetueshme;

Shërbimi Korrektues i Kosovës pajtohet me Komitetin mbi rëndësinë e parandalimit të përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme brenda institucioneve korrektuese. Prandaj, të burgosurit e posa arritur testohen për sëmundje të transmetueshme nëse ka dyshime, bazuar në kontrollimin klinik, se personi në fjalë është i infektuar me të. Ashtu siç parashihet me ligj, testi mund të bëhet vetëm nëse personi e jep pëlqimin e tij.

Paragrafi 95

Komiteti rekomandon që menaxhmenti i burgut të Dubravës dhe të gjitha qendrat tjera të paraburgimit në Kosovë të udhëzohen që të gjitha kontrollimet mjekësore të të burgosurve (qoftë me rastin e arritjes apo në një fazë të mëvonshme) të bëhen pa praninë e zyrtarëve të burgut, përveç nëse mjeku në fjalë kërkon ndryshe në ndonjë rast të veçantë.

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës pajtohen se kontrollimet mjekësore duhet të bëhen në kushte ku nxitet besimi në mes të të burgosurit dhe stafit mjekësor. Prandaj, është rregull e përgjithshme në institucionet korrektuese, që kontrollimet mjekësore të bëhen pa praninë e zyrtarëve të burgut, përveç nëse kërkohet ndryshe nga stafi mjekësor në raste të veçanta.

Paragrafi 85

Komiteti dëshiron të përkujtojë se stafi jomjekësor nuk duhet të kontrollojë kërkesat për konsultime mjekësore;

Të gjitha vendimet lidhur me kërkesat e të burgosurve për konsultime mjekësore merren nga stafi mjekësor. Rolin e vetëm që e kanë zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës është që, në procedurë administrative, të marrin kërkesat dhe këto t'ua komunikojnë shërbimeve mjekësore.

Paragrafi 93

Do të ishte e dëshirueshme që në të gjitha institucionet ndëshkimore të bëhet një regjistër specifik për regjistrimin e lëndimeve të vërejtura tek të burgosurit pas pranimit të tyre apo qëndrimit në burg.

Ky regjistër ekziston që nga 1 korriku 2007. Përveç kësaj, lëndimet gjithashtu regjistrohen në dosjen mjekësore të personit të burgosur.

Paragrafi 96

Do të ishte e dëshirueshme që informacionet themelore për sëmundjet e transmetueshme (siç është tuberkulozi, SIDA dhe hepatiti) të burgosurve t'ju jepen në formë të shkruar vazhdimisht nga stafi i kujdesit shëndetësor (p.sh. fletëpalosje), në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë.

Fondi Global aktualisht është duke financuar dhe implementuar projektin mbi tuberkulozin në qendrat e paraburgimit dhe në burgjet e Kosovës. Ky projekt përfshin trajnimin e stafit, trajtimin e tuberkulozit dhe identifikim më të mirë të sëmundjes.

Fondi Global gjithashtu ka ofruar trajnim për stafin mbi HIV/AIDS dhe një projekt i ri është në fazën e planifikimit. Ky projekt do të përfshijë kërkimin, trajnimin, trajtimin, testimin, si dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve si dhe materiale të tjera informative mbi HIV/AIDS.

Aktualisht, të burgosurve u sigurohen kondomë, të dhuruar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë, falas në hapësirën e spitalit para se ata të shkojnë për vizitë në shtëpi.

Paragrafi 86

Komiteti dëshiron të merr komentet e UNMIK-ut mbi vërejtjet e delegacionit në burgun e Dubravës se në raste të caktuara kishte pasur vonesa të konsiderueshme në hospitalizimin e të burgosurve, veçanërisht ata që kanë qenë për operacione;

Spitalet civile janë nën autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës koordinon me këtë Ministri kur të burgosurit duhet të hospitalizohen. Në përgjithësi, një koordinim i tillë ka qenë i mirë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka regjistruar vonesa të hospitalizimit në raste emergjente.

Për rastet jo-urgjente, vonesa të vogla mund të paraqiten, varësisht nga kapacitetet e spitaleve vendore. Në këto raste, kur ka pasur vonesa, nuk ka të dhëna për pasoja negative mjekësore. Në këtë aspekt, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka vërejtur se, disa kërkesa për operacione nga të burgosurit janë të lidhura me probleme jo-urgjente që kanë ekzistuar para burgosje së tyre. Derisa janë në burg, të burgosurit mund të bëjnë kërkesë për operacion, i cili regjistrohet dhe trajtohet, varësisht nga prioritetet e gjendjes së pacientit dhe kapaciteteve të spitaleve vendore.

Paragrafi 90

Komiteti dëshiron të merr komentet e UNMIK-ut mbi vështirësitë e raportuara në transferimin e të burgosurve të cilët kanë nevojë për kujdes psikiatrik nga qendra e paraburgimit të Mitrovicës në spitalin rajonal në veri të Mitrovicës.

Aktualisht, situata e vështirë politike në Mitrovicë ka rezultuar me vështirësi operacionale për institucionet, duke përfshirë edhe lëvizjen e të burgosurve. Divizioni i UNMIK-ut për menaxhimin e burgjeve është bashkëbiseduesi kryesor që lehtëson komunikimin ndërmjet qendrës së paraburgimit në veri të Mitrovicës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe e njofton drejtorin e qendrës së paraburgimit në Mitrovicë. UNMIK-u lehtëson transferimin e të burgosurve në spitalin në veri të Mitrovicës me të cilin ka arritur një mirëkuptim. Përveç kësaj, një mjek ndërkombëtar është në dispozicion çdo ditë.

Sa i përket kujdesit psikiatrik, Divizioni i UNMIK-ut për menaxhimin e burgjeve e viziton qendrën e paraburgimit një herë në javë me një psikiatër ndërkombëtar.

Çështje të tjera

Paragrafi 97

Komiteti rekomandon që në të gjitha institucionet ndëshkimore në Kosovë të implementohen rregullat që kontaktet me familje asnjëherë të mos ndalohen plotësisht si dënim dhe se kufizimet e kontakteve me botën e jashtme të shqiptohen për një kohë sa më të shkurtër të mundshme dhe, si rregull, të mos shqiptohen për të burgosurit e mitur;

Shërbimi Korrektues i Kosovës është i vetëdijshëm për rëndësinë e marrëdhënieve familjare në kontekstin e rehabilitimit dhe reintegrimit të të burgosurve në shoqëri. Prandaj, kontaktet familjare nuk janë të ndaluara por përkundrazi inkurajohen. Staf i profesional në institucionet korrektuese i mbështet të burgosurit në mbajtjen e kontakteve dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me familjet e tyre. Me rastin e pranimit, të burgosurit informohen për mjetet e komunikimit me botën e jashtme që i kanë në dispozicion.

Paragrafi 98

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar që të gjithë të burgosurve të cilët i nënshtrohen dënimit disiplinor t'ju jepet e drejta formale për të paraqitur ankesë;

Sipas procedurës standarde për veprime, të gjithë të burgosurit kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër masave disiplinore, kjo përfshin procedurën e cila siguron që parashtruesi i ankesës të merr përgjigje me shkrim.

Paragrafi 99

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet e vizituara ndëshkimore për të siguruar që të gjithë të burgosurit:

- **kanë mundësinë e dëgjimit në procedurë disiplinore;**

Sipas rekomandimeve të Komitetit, janë ndërmarrë hapa për të siguruar që dëgjimi organizohet para shqiptimit të masës disiplinore.

- **marrin një kopje të vendimit disiplinor, duke i informuar ata për arsyet e**

vendimit dhe rrugët e paraqitjes së ankesës. Të burgosurit në fjalë duhet të konfirmojnë me shkrim se ata kanë marrë një kopje të vendimit;

Të burgosurve u jepet vendimi me shkrim ku detajohet shkelja, duke i informuar ata për masën disiplinore dhe të drejtën e tij për të paraqitur ankesë kundër vendimit.

Paragrafi 100

Komiteti rekomandon që të rishikohet masa ekzistuese ligjore dhe praktika lidhur me rolin e mjekëve të burgut lidhur me çështjet disiplinore. Duke e bërë këtë, duhet pasur parasysh Rregullat e ndryshuara evropiane të burgut dhe komentet e bëra nga Komiteti në paragrafin 53 të raportit të tij të përgjithshëm të 15-të (Komiteti/Inf. (2005) 17).

Mjekët më nuk janë të përfshirë në vendimet mbi shqiptimin e masave disiplinore. Mirëpo, ata vizitojnë të burgosurit e vendosur në burgosje njësh çdo ditë dhe mund të këshillojnë se janë kundër vazhimit të masës, nëse është e nevojshme.

Paragrafi 101

Komiteti duhet të potencojë se për arsye të madhësisë, qelia disiplinore në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë nuk është e përshtatshme për akomodim gjatë natës. Për të burgosurit që i nënshtrohen burgosjes njësh duhet të gjendet një zgjidhje alternative.

Kjo qeli është mbyllur menjëherë pas vizitës së delegacionit.

Institucionet nën autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale

C. Institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale

Vërejtjet preliminare

Paragrafi 105

Komiteti kërkon nga UNMIK-u që të bën çdo përpjekje për të lehtësuar implementimin në praktikë të rekomandimeve dhe komenteve të bëra në paragrafët 111, 112, 123, 127, 131 deri në 133, 136, 138 dhe 139 lidhur me Njësinë e psikiatrisë dhe neurologjisë në spitalin rajonal të Mitrovicës.

Fusha e kujdesit shëndetësor është fushë e transferuar e kompetencave të cilat janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilën UNMIK-u ka pasur përfshirje të kufizuar. Mirëpo, për shkak të situatës së vështirë politike në veri të Mitrovicës, kjo Ministri edhe në të kaluarën ka pasur përfshirje të kufizuar në institucionet e kujdesit shëndetësor të vendosura në këtë rajon. Këto institucione të kujdesit shëndetësor kryesisht financohen nga grantet e Qeverisë së Serbisë dhe menaxhohen nga serbët e Kosovës të cilët jetojnë atje.

Keqtrajtimi

Paragrafi 106

Komiteti rekomandon që i tërë stafi në institucionet me persona me paaftësi mentale në Shtime të përkujtohet se të gjitha format e keqtrajtimit të banorëve janë të papranueshme dhe do t'ju nënshtrohen sanksioneve;

Ministria e Shëndetësisë është duke bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të përmirësuar shërbimet e ofruara në Institucionin special në Shtime. Deri në qershor 2008, problemet strukturore si dhe menaxhmenti jo-efikas ishin arsye për shqetësime dhe kjo ofronte udhëzime të dobëta për stafin. Prandaj, ky institucion i është nënshtruar ristrukturimit dhe, që nga qershori 2008, menaxhmenti i ri ka marrë përgjegjësitë. Janë mbajtur takime të rregullta me stafin për të nxitur vetëdijesimin për trajtimin e duhur dhe për të përkujtuar stafin se keqtrajtimi është absolutisht i ndaluar.

Ministria i bëri një vizitë këtij institucioni në shtator të vitit 2008 për të vlerësuar situatën. Përmes diskutimeve me pjesëtarët e stafit si dhe me pacientët, këto zhvillime pozitive janë konfirmuar dhe nuk janë raportuar incidente të keqtrajtimit.

Për të mbështetur stafin mjekësor dhe rregullsitë në punën e tyre të përditshme, do të organizohen trajnime. Gjatë këtij viti do të implementohen trajnime institucionale, duke shfrytëzuar kapacitetet e Shtimes si dhe qendrën e kujdesit mental në Ferizaj. Ministria e Shëndetësisë gjithashtu ka pranuar oferta nga organizata joqeveritare për të ofruar trajnime, të cilat do të mbahen në vitin 2009.

Në përpjekjet e mëtejshme për të luftuar keqtrajtimin, Ministria ka kërkuar nga një organizatë joqeveritare që të vizitojë institucionin special në Shtime dhe Ministrisë t'i sigurojë raport ku do të përfshihen komentet dhe rekomandimet lidhur me përmirësimet e nevojshme.

Paragrafi 107

Komiteti rekomandon që stafi në “Institucionin special” në Shtime të përdor të gjitha mjetet në dispozicion për të parandaluar dhunën ndërmjet pacientëve/banorëve dhe kërcënimin; për të ndaluar këtë problem, stafi duhet të jetë vigjilent për shenjat e shqetësimeve, dhe ata duhet të jenë të vendosur dhe të trajnuar në mënyrën e duhur për të intervenuar kur është e nevojshme.

Ministria është e vetëdijshme se trajnimi është aspekt esencial për zhvillimin profesional të stafit. Mirëpo, kufizimet e rënda buxhetore ishin pengesë për implementimin e trajnimeve sistematike institucionale.

Meqë menaxhmenti i ri për qendrën e integritit për shëndetin mental ka filluar punën, buxheti është rialokuar dhe trajnimet institucionale duhet të fillojnë në gjysmën e dytë të vitit 2008. Nën përgjegjësinë e drejtorit të ri, stafi mjekësor veç është alarmuar për të zbuluar sinjalet e problemeve potenciale. Këto tema do të diskutohen gjithashtu gjatë trajnimeve të cilat do të mbulojnë të gjitha aspektet e punës së përditshme të stafit, duke përfshirë edhe parandalimin e dhunës ndërmjet pacientëve/banorëve.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke ofruar trajnime profesionale të bazuara në nevojat për pjesëtarët e stafit duke mbuluar të gjitha aspektet e punës së tyre të përditshme. Këto trajnime implementohen qoftë nga vet Ministria, apo në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.

Kushtet e jetesës së pacientëve/banorëve

Paragrafi 110

Komiteti rekomandon që autoritetet të vazhdojnë përpjekjet e tyre dhe ta konsiderojnë si çështje prioritare për të siguruar që të gjithë pacientëve të mbajtur në njësitë e mjekësisë ligjore të klinikës psikiatrike në Prishtinë t'u ofrohet, nëse gjendja e tyre shëndetësore këtë e lejon, së paku një orë ushtrime jashtë çdo ditë;

Në fillim, Ministria e Shëndetësisë dëshiron të bëjë me dije se njësia e mjekësisë ligjore e klinikës psikiatrike në Prishtinë është pjesë e departamentit psikiatrik A (psikiatra e përgjithshme për pacientë meshkuj). Departamenti A është përgjegjësi e ndarë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Derisa menaxhmenti është në duart e stafit mjekësor, siguria sigurohet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Pas diskutimeve ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Drejtësisë, është vendosur për një sistem të ushtrimeve në ajër të pastër. Pacientëve të mbajtur në njësinë e mjekësisë ligjore tani u ofrohet një orë ushtrime jashtë çdo ditë. Për shkaqe të sigurisë, pacientët shoqërohen me garda gjatë kësaj kohe.

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë është duke përfunduar një projekt, i cili siguron përmirësimin e kushteve të jetesës brenda klinikës psikiatrike si dhe trajnim për stafin. Ky projekt do të financohet nga Qeveria e zvicëranë.

Kështu, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ndërtimi i një institucioni të ri psikiatrik të mjekësisë ligjore është duke u planifikuar dhe ky projekt aktualisht pret miratimin.

Paragrafi 116

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa shtesë si çështje prioritare për të përmirësuar kushtet e jetesës për pacientët në qendrën e integritit për shëndet mental në Shtime, duke pasur parasysh vërejtjet e bëra në paragrafët 115 dhe 116.

Ministria e Shëndetësisë pajtohet për nevojën e përmirësimit të kushteve të jetesës në qendrën e integritit për shëndet mental dhe ka siguruar që ky institucion të sigurojë buxhetin e vet. Një linjë e veçantë buxhetore do të miratohet me buxhetin e vitit 2009. Megjithatë, disa përmirësime veç janë arritur që nga vizita e delegacionit.

Janë siguruar fonde të mjaftueshme për të siguruar nxehjen gjatë dimrit dhe janë bërë ftesat për tender për blerjen e gjeneratorëve. Furnizimi me ushqim gjithashtu është përmirësuar dhe janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e higjienës.

Ministria do të shpall tender për renovimin e qendrës së integritit për shëndetin mental në gjysmën e dytë të vitit 2008. Për shkak të kufizimeve buxhetore, tenderi do të mbulojë vetëm renovime brenda objekteve. Ftesa për tender që do të mbulojë renovimin e lokaleve të mbetura do të bëhet në vitin 2009.

Paragrafi 113

Duhet ndërmarrë hapa për të ofruar një ambient më personal për banorët e institucionit për persona me paaftësi mentale në Shtime.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale pajtohet se ambienti personal është një element i rëndësishëm që i kontribuon mirëqenies së banorëve. Prandaj, Ministria dëshiron të potencojë se bëhen përpjekje për të transferuar banorët e institucionit special në shtëpi të bazuara në komunitet, të cilat ofrojnë kushte më të mira jetese. Aktualisht janë shtatë shtëpi të bazuara në komunitet: Pesë shtëpi për persona të rritur me paaftësi mentale, dhe dy persona me paaftësi mentale dhe fëmijë të braktisur.

Shtëpitë e bazuara në komunitet kanë kapacitete të strehojnë dhjetë persona secila, dhe 11 pjesëtarë të stafit janë siguruar për këta banorë në çdo shtëpi. Stafi kryen aktivitete të përditshme së bashku me banorët, të ngjashme me ato që kryhen brenda familjes. Kjo qasje është dëshmuar si e suksesshme për integrimin e banorëve dhe ka bërë përmirësime të përgjithshme në mirëqenien e tyre.

Transferim i banorëve e ka zvogëluar numrin e tyre në Shtime në 60. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vazhdon të kërkojë mundësi të reja për banorët e mbetur, qoftë përmes ndërtimit të shtëpive të reja të bazuara në komunitet ose ribashkimit familjar, kur kjo është e mundshme.

Stafi

Paragrafi 118

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar vijimin e rregullt të pjesëtarëve të stafit të kujdesit shëndetësor në njësitë e mjekësisë ligjore në klinikën psikiatrike në Prishtinë;

Ministria e shëndetësisë pajtohet se situata lidhur me praninë e stafit në njësitë e mjekësisë ligjore duhet të përmirësohet. Në Kosovë, aktualisht është vështirë të gjendet staf i kualifikuar në fushën e shëndetit mental dhe të tërhiqen psikiatër në njësinë e mjekësisë ligjore. Megjithatë, mjekët dhe infermieret të cilët punojnë për klinikën psikiatrike janë në dispozicion për njësinë e mjekësisë ligjore 24 orë për çdo ditë në rast nevojë, përveç pranisë së rregullt të stafit mjekësor që e ka vërejtur delegacioni i Komitetit gjatë vizitës së tij.

Paragrafi 120

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa nga autoritetet relevante për të siguruar që në qendrën e integritit për shëndet mental në Shtime:

- **kujdesi psikiatrik të rritet duke pasur së paku një psikiatër që do të ishte ekuivalent me një post me orar të plotë për psikiatër;**

Që nga vizita e delegacionit, situata është përmirësuar: është punësuar një psikiatër nga qendra e shëndetit mental në Ferizaj me gjysmë orari. Në kombinim me një psikiatër të dytë, i cili punon me gjysmë orari, kujdesi psikiatrik është rritur në nivel që është ekuivalent me një post të psikiatrit me orar të plotë.

- **numri i stafit të infermierisë dhe i pastruesve është rritur.**

Aktualisht, kufizimet buxhetore nuk lejojnë rritje të numrit të infermiereve dhe pastruesve. Mirëpo, janë duke u bërë përpjekje për të përmirësuar situatën. Për vitin 2009, janë kërkuar edhe 40 pjesëtarë shtesë të stafit në Qendrën e integritimit për shëndetin mental.

Trajtimi

Paragrafi 123

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara dhe posaçërisht në “Institucionin special” në Shtime, për të zhvilluar trajtim dhe aktivitete rehabilitimi për pacientët/banorët psikiatrik që do të mundësonte gjithashtu reduktim e përdorimit të mjekimit psikiatrik.

Ministria e Shëndetësisë pajtohet se pacientët psikiatrik përfitojnë nga trajtimi dhe aktivitetet e rehabilitimit. Sidoqoftë, problemi i shpeshtë i mungesës së stafit të kualifikuar vështirëson përmirësimin e trajtimit të administruar nga Institucionin special. Për më tepër, kufizimet financiare vazhdojnë të jenë pengesë për organizimin e trajnimit adekuat të stafit.

Megjithatë, është vërejtur një rënie në administrimin e mjekimit psikotropik që nga qershori i vitit 2008, kur menaxhmenti i ri ka marrë detyrën.

Në institucionet tjera psikiatrike, siç është Klinika psikiatrike në spitalin e Universitetit të Prishtinës, zgjidhja e numrit adekuat të stafit dhe trajtimeve moderne, siç janë terapitë në grup dhe aktivitetet rehabilituese, tanimë janë të gatshme.

Kufizimet e pacientëve/banorëve të shqetësuar dhe/ose dhunshëm

Paragrafi 125

Komiteti rekomandon që të ndërpritet praktika e prangosjes së pacientëve të shqetësuar për shtretërit e tyre në njësitin mjeko-ligjor të Klinikës psikiatrike në Prishtinë; nëse kërkohet kufizim automatik, mjete alternative duhet të përdoren (p.sh. rripi)

Pas vizitës së delegacionit, praktika e prangosjes së pacientëve të shqetësuar për shtretërit e tyre është ndaluar. Incidentet që përfshijnë banorët në njësitë mjeko-ligjor menaxhohen nga stafi mjekësor, në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Pjesëtarët e stafit janë trajnuar t'i afrohen një pacienti të shqetësuar apo të dhunshëm dhe të mbajnë situatën nën kontroll derisa mjekimi të ketë efekt. Për këtë arsye, do të sigurohen trajnime të mëtejshme të stafit mjekësor.

Pas çdo incidenti, anëtari i përfshirë i stafit harton një raport për incidentin për të siguruar transparencë dhe ndjekje, nëse kjo e fundit është e nevojshme.

Paragrafi 126

Komiteti rekomandon që stafi kujdestarë në Qendrën integruese të shëndetit mental në Shtime të njoftohet se kufizimi kimik gjithmonë duhet të urdhërohet nga një mjek;

Ministria e Shëndetësisë pajtohet se dhënia e medikamenteve është përgjegjësi e mjekëve. Kështu, pas vizitës së delegacionit stafi mjekësor është udhëzuar që sipas ligjit dhe rregullave administrative, ²¹përshkrimi i kufizimeve kimike gjithmonë duhet të urdhërohet nga një mjek.

Paragrafi 127

Komiteti rekomandon që në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara të formohen regjistra specifik me detaje për përdorimin e mjeteve të shtrëngimit.

Sipas Ligjit mbi shëndetësinë, ²² çdo institucion mjekësor duhet të mbajë regjistra. Kështu, në të gjitha institucionet psikiatrike ekziston një regjistër specifik në lidhje me mjetet e shtrëngimit. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit gjithashtu raportohet në dosjen e pacientit.

Mbrojtja

Paragrafi 131

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të siguruar implementimin efektiv të dispozitave relevante ligjore të zbatueshme në Kosovë që rregullojnë vendosjen e pavullnetshme të pacientëve. Për këtë qëllim, gjykatat kompetente duhet të informohen për të gjithë personat që aktualisht mbahen në secilin institucion psikiatrik të vizituar në mënyrë të pavullnetshme.

Çdo pacient i pranuar pa vullnetin e tij në një institucion psikiatrik regjistrohet në një regjistër të veçantë. Dosja e tij përmban historinë e tij mjekësore si dhe një raport me të gjitha kontrollat mjekësore. Brenda tri ditëve pas pranimit të tij, ky regjistër i dërgohet gjykatës përkatëse. Sipas ligjit, tre ekspertë mjekësorë i dorëzojnë gjykatës opinionet e tyre mbi shëndetin e pacientit.

Kjo procedurë respektohet pasi që asnjë pacient nuk mund të pranohet në institucion psikiatrik pa u dhënë miratimi, përveç nëse është urdhëruar nga gjykata.

Paragrafi 132

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në “Institucionin special” të Shtimes dhe në institucione të tjera të dhura të mirëqenies shoqërore/institucione psikiatrike në Kosovë, për të siguruar që gjykatat kompetente njoftohen për të gjithë pacientët/banorët për të cilët supozohej se janë të paafte për të dhënë pëlqimin për vendosjen e tyre;

²¹ Udhëzimi administrativ ‘Shëndetësia’ nr. 01/2003 ‘Përshkrim unik i vendit të punës për profesionistë të shëndetësisë MSH/2006.

²² Kapitulli XI, nenet 62,63 dhe 64, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/31 mbi shpalljen e Ligjit të Kosovës mbi shëndetësinë, 20 gusht 2004, “Sistemi i të dhënave mjekësore”.

Pranimi i një pacienti në “Institucionin special” të Shtimes pa miratimin e pacientit mund të ndodhë vetëm pas urdhrit të gjykatës. Një urdhër të tillë gjykata mund ta lëshojë kur ajo është e informuar për gjendjen e pacientit dhe trajtimin e kërkuar, për të cilin kërkohet miratimi i pacientit.

Para se të lëshohet urdhri i gjykatës, Ministria e Shëndetësisë, përmes një procedure të brendshme, i cakton pacientit një punonjës social ose anëtar të familjes si kujdestar.

Kur personat janë pranuar në Institucionin special në bazë të urdhrit të gjykatës, periudha e qëndrimit është e kufizuar në gjashtë javë. Gjendja shëndetësore e pacientit kontrollohet vazhdimisht dhe anëtarët e familjes mund të kërkojnë tërheqjen e tij nga Institucioni.

Së fundi, Ministria e Shëndetësisë ka këshilluar drejtorin e Institucionit Special të Shtimes që të informojnë gjykatat për të gjithë pacientët e regjistruar që janë vendosur pa pëlqimin e tyre, në mënyrë që të rishikojnë vendosjen e tyre.

Ministria e Shëndetësisë ka filluar një bashkëpunim me Institucionin e Ombudspersonit për mbikëqyrjen e personave të vendosur në mënyrë të pavullnetshme. Deri tani asnjë nga vendosjet e pavullnetshme nuk është kontestuar nga Ombudspersoni.

Paragrafi 133

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa nga autoritetet relevante për të siguruar që, në kontekstin e masës së gjykatës për të privuar një banor/pacient nga aftësinë ligjore dhe të caktojnë një kujdestarë, personave në fjalë u është:

- dhënë e drejta nga gjykata për tu dëgjuar
- dhënë një kopje e vendimit të gjykatës
- janë informuar në mënyrë të shkruar dhe gojore për mundësinë dhe mënyrat e paraqitjes së apelit kundër vendimit të gjykatës;

Për më tepër, Komiteti rekomandon të ndërmerren hapa për të siguruar që nevoja për vendosjen e personave nën kujdestari në një institucion mirëqenieje shoqërore/psikiatrik të kontrollohet në intervale të rregullta nga autoriteti përkatës;

Ministria e Shëndetësisë pajtohet me këto masa, veçanërisht pasi ato urdhërohen me ligj. Prandaj, Ministria do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar implementimin e Ligjit të vitit 1986 mbi procedurën jokontestimore.

Paragrafi 135

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa nga autoritetet përkatëse për të siguruar që të gjitha vendosjet për trajtime të detyrueshme të kontrollohen rregullisht, siç parashihet me ligj;

Ministria e Shëndetësisë do ta ketë për detyrë të sigurojë që mbrojtja e parashikuar me ligj të respektohet plotësisht.

Paragrafi 136

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet e vizituara të mirëqenies sociale/psikiatrike për të siguruar që të gjithë pacientëve/banorëve (si dhe familjeve të tyre) t'ju sigurohet një broshurë me rastin e pranimit me rregullat dhe rutinën e institucionit;

Të gjithë pacientët/banorët marrin fletëpalosje me informata për të drejtat e tyre dhe gjithashtu për procedurat e zbatueshme brenda institucionit. Për më tepër, posterë vendosen në gjithë institucionin për të detajizuar të drejtat e pacientëve/banorëve.

Paragrafi 138

Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet e vizituara të mirëqenies sociale/psikiatrike për të siguruar që të gjithë pacientëve/banorëve, duke përfshirë edhe ata që janë vendosur në baza jovullnetare, u jepet rasti të refuzojnë (personalisht ose nëpërmjet kujdestarit të tyre) trajtimin apo çfarëdo intervenimi tjetër mjekësor, në frymën e vërejtjeve të të paraqitura në paragrafët 137 dhe 138.

Ministria e Shëndetësisë i jep rëndësi të veçantë respektimit të të drejtave të pacientëve për të qenë të informuar për gjendjen e tyre shëndetësore, trajtimin e propozuar, si dhe për të refuzuar çfarëdo lloj intervenimi mjekësor.

Siç është përcaktuar në Ligjin mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve kosovarë në sistemin e kujdesit shëndetësor²³ të gjithë pacientët, përfshirë edhe ata që janë vendosur në baza jovullnetare, kanë të drejtë të refuzojnë trajtimin. Trajtimi mund të imponohet vetëm në raste speciale me rrezik për jetën dhe në bazë të ligjit.

Paragrafi 139

Komiteti rekomandon që në të gjitha institucionet e vizituara të mirëqenies sociale/psikike pacientët/banorët të informohen për të drejtat e tyre si dhe për mënyrat e paraqitjes së ankesave nga fletëpalosjet/broshurat, të lëshuara me rastin e pranimit;

Të gjithë pacientët/banorët informohen gojarisht, dhe gjithashtu përmes fletëpalosjeve, për të drejtat e tyre dhe shërbimet e ofruara brenda institucionit. Lista e të drejtave në fletëpalosje përfshin të drejtën për të paraqitur ankesë.

Paragrafi 140

Komiteti rekomandon që sistemi i bordeve të vizitorëve të riaktivizohet dhe këtyre bordeve tu sigurohen burimet adekuate në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive.

Më tej, Komiteti fton autoritetet të formojnë një mekanizëm për vizita të ngjashëm me bordin e vizitorëve për institucionet e mirëqenies shoqërore.

Bordi i vizitorëve ishte mekanizëm i financuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Si i tillë, Bordi u kritikua nga shoqëria civile që dyshonte në pavarësinë e tij. Përfundimisht, më 2005 u mor vendim që të ndërpritet financimi i punës së Bordit.

²³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/47 mbi Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, 19 nëntor 2004.

Aktualisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale po përpiket të kthejë në jetë bordin e vizitorëve, por ende nuk ka gjetur donator që do të financonte punën e tij.

Megjithatë, institucionet psikiatrike janë të hapura për vizita nga organizatat joqeveritare dhe institucioni i Ombudspersonit.

Paragrafi 134

Komiteti do të dëshironte të pranonte komente nga UNMIK-u në lidhje me vështirësitë e hasura nga menaxhmenti në “Institucionin Special” në Shtime për të planifikuar transferimin e një grupi prej 20 pacientëve/banorëve me origjinë serbe të mbajtur në institucion për t’i vendosur në një institucion adekuat të kujdesit në territorin e Serbisë.

Pacientët/banorët me origjinë serbe paraqesin një sfidë pjesërisht për shkak të ndjeshmërive të përfshira politike. Pas vlerësimit të situatës së tyre, Ministria e Shëndetësisë konkludoi se ata janë lënë në Kosovë pasi familjet e tyre nuk kanë dashur të jenë përgjegjës për ta.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq është informuar për prezencën e këtij grupi, por aktualisht nuk është e mundur që ata të dërgohen prapa në Serbi.

Këta pacientë/banorë marrin trajtim adekuat dhe rastet e tyre rivlerësohen kohë pas kohe.